


# Prishtina po bëhet

RAPORTI  
2014-2015



✓ Janë investuar mbi **41,283.600 milion euro** në investime kapitale

✓ Kemi hapur tregun për shitjen e prodhimeve vendore për **1200 bujq**

✓ Kemi mbajtur **95 diskutime** publike me qytetarë

✓ Janë mbjellë **3,500** drurë dekorativë dhe janë rikultivuar **17,244 m<sup>2</sup>** të sipërfaqeve të gjelbra

✓ Janë mbjellë **602,685** lule sezonale dhe **95,470** lule shumëvjeçare

✓ Kemi bërë pastrimin e **120** deponive ilegale

✓ Kemi rregulluar **131.42km** kanalizim fekal dhe **17.23km** kanalizim atmosferik

✓ Kemi dhënë **235 leje ndërtimi**

✓ Kemi proceduar mbi **90 raste** në prokurori

✓ Kemi hapur **3 çerdhe**

✓ Kemi bërë ndriçimin e **94km rrugëve**

✓ Kemi ndërtuar **175.43km rrugë**



**Prishtina po bëhet.** Është ky slogani që e kemi përdorur gjatë dy viteve të fundit. Jo për të thënë që Prishtina nuk ka qenë para këtyre dy viteve, por për të thënë që Prishtina ka qenë në vështirësi të mëdha; për të thënë që problemet kanë rrezikuar të ardhmen e qytetit; për të thënë që normaliteti po kthehet; por edhe për të na kujtuar se jemi në proces e sipër dhe se kemi edhe shumë punë për të bërë.

Filluam nga baza, e ajo është planifikimi. 46 mijë ndërtime pa leje, plane rregullative fiktive, 1 mijë leje të dhëna me rregull e pa rregull dhe mungesa e investimeve në infrastrukturë shkaktuan një kaos dhe mungesë të shërbimeve infrastrukturore. Qytetarët kishin ndjenjën se me lidhje e para mund të ndërtonin në çdo cep, pa konsideratë për bashkëqytetarët, ligjin dhe barazinë. Qytetarët e pafuqishëm para pushtetit ankoheshin për degradimin e qytetit.

Ndaluam ndërtimet pa leje dhe po prijme në procesin e legalizimit. Reformuam procesin e lejeve dhe stabilizuam ndërtimet. Krijuam hapësira publike dhe po punojmë në mobilitet. Po krijojmë lagje të reja me planifikim të mirëfilltë. Do të duhen vite të rimëkëmbemi, por Prishtina po bëhet.

Vazhduam me përmirësimin e shërbimeve në shëndetësi, administratë e shërbime publike. Certifikatat jepen në kohë rekorde, shërbimet u dixhitalizuan, të gjitha QMF-të u renovuan dhe u përmirësua infrastruktura shëndetësore. Sot, në Prishtinë fëmijët në shkolla kontrollohen në mënyrë sistematike. Është vënë rregulli dhe rendi në sistemin e shfrytëzimit të hapësirave publike. Të gjitha ndërmarrjet publike kanë filluar që nga humbjet marramendëse të kthehen në ndërmarrje fitimprurëse.

Liriuam trotore dhe përmirësuam dukshëm infrastrukturën rrugore në qytet e në fshatra. Rritëm dukshëm numrin e drurëve dekorativë dhe ndërtuam dy parqe të reja. Fëmijët e klasave 1 - 5 tashmë me kiflet marrin edhe qumësht falas. Thelluam marrëveshjet ndërkombëtare me qytetet e tjera dhe tërhoqëm investime në komunën tonë.

Lista vazhdon më tutje në këtë raport. Aty mund t'i gjeni lagjet tuaja, shërbimet për familjet tuaja e shumë projekte të tjera. Por më me rëndësi për neve është që ju ta dini se qyteti është i juaji e ne vetëm shërbejmë. Ky qytet do jetë gjithmonë i qytetarëve të Prishtinës. Të keqën po e ndalim e të mirën po e ndërtojmë, bashkë.

Ju uroj shëndet e të gjitha të mirat në vitin 2016!

*Shpend Ahmeti*



# 12 ZOTIMET

## Për mandatin 2014-2017 ne u zotuam që do të realizojmë:

---



### Furnizim i pandërprerë me ujë për 24 muaj

- Vlerësimi i humbjeve
- Plani investimeve kapitale
- Realizimi i investimeve



### Arsimi në shërbim të zhvillimit

- Përzgjedhja e drejtorëve me pjesëmarrje në komunitet
- Vlerësimi i punonjësve të arsimit në bazë të performancës
- Shujta falas për klasat e ciklit të ulët
- Investim në pajisje shkollore për të lehtësuar çantat e fëmijëve



### Tregu i prodhimeve të vendit

- Treg për bujqit vendorë, që në Prishtinë t'i shesin prodhimet e tyre pa taksa shtesë
- Lidhja në mes të institucioneve dhe grupeve të tjera në Prishtinë me prodhuesin vendor



### Çerdhe me kosto të përballeshme në çdo pjesë të komunës

- Vlerësimi i nevojave
- Diskutimet publike
- Plan aksionar për çerdhet



## Barazi në Prishtinë

- Programi për qasje në institucionet publike për personat me nevoja të veçanta
- Programi i integritit të fëmijëve me nevoja të veçanta
- Heqja e taksave administrative për rastet sociale dhe programe të lirimit nga pagesa e shërbimeve komunale për grupet e rrezikuara



## Banim i përballueshëm

- Banim i përballueshëm për punpunonjësit të sektorit publik
- Mundësi për shërbyesit publikë që shërbejnë më shumë se 10 vjet në sektorin publik



## Shëndeti në shërbim të zhvillimit

- Zonimi i qytetit: çdo banor ka mjekun e vetë
- Sistemi i informimit në shëndetësi, çdo banorë ka kartelën e vetë digjitale
- Shërbime të rregullta mjekësore e stomatologjike në shkolla për qëllime preventive
- Shërbime të patronazhit, vizita për pacientët në nevojë nëpër shtëpitë e tyre



## Reformimi i tatimit në pronë

- Shkallët e reja të tatimit në pronë sipas gjendjes materiale dhe numrit të banorëve në objektet banesore



## Rregullimi i trafikut në Prishtinë

- Reformimi i transportit publik
- Sistem i ri i linjave me orar të parashikueshëm që mbulon të gjitha lagjet
- Sistem i ri i pagesave
- Transporti falas për pensionistë, raste sociale dhe grupe të tjera
- Politika të kufizimit të qarkullimit të makinave në qendër



## Vendosja e rregullit në planifikim urban

- Planet rregulluese
- Përfundimi i procesit të legalizimit të ndërtimeve
- Ndalja e ndërtimeve pa leje



## Hapja e Komunës për qytetarë

- Në kërkesat administrative jetpet përgjigje para afatit ligjor
- Qytetarët informohen nga Komuna për kërkesat e tyre
- Publikimi i raporteve financiare çdo tre muaj
- Prokurimi sipas modelit të transparencës radikale
- Punësim sipas modelit të anonimitetit që është aprovuar në shtetet e Bashkimit Evropian



## Vendimmarrja në lagje

- Funkcionalizimi i bashkësive lokale për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve
- Riorganizimi i këshillave të lagjeve dhe ndërtesave



2014

2015

2016

2017

Vetëm gjatë gjysmës së mandatit tonë,

ne kemi arritur të realizojmë **75%**

të zotimeve që kemi prezantuar  
gjatë fushatës zgjedhore.





## Çerdhe me kosto të përballueshme në çdo pjesë të komunës

- ✓ **Vlerësimi i nevojave** - Është bërë vlerësimi i nevojave për çerdhe në të gjitha lagjet dhe fshatrat e komunës së Prishtinës dhe kemi përgatitur planin aksionar për hapjen e çerdheve të reja, me çmim të përballueshëm, në çdo pjesë të Prishtinës.
- ✓ Hapja e çerdhes *"Botanika"*, në lagjen "Mati II" – 80 fëmijë, më 17 gusht 2015
- ✓ Hapja e çerdhes *"Ngjyrat"*, në lagjen "Hajvalia" – 40 fëmijë, më 26 tetor 2015
- ✓ Hapja e çerdhes *"Shtëpia Magjike"*, në fshatin "Besi" – 40 fëmijë, më 18 dhjetor 2015
- ✓ Fillimi i ndërtimit të çerdhes në lagjen "Arbëria III" dhe "Kodra e Trimave", 240 fëmijë
- ✓ Fillimi i procedurave për hapjen e çerdhes në lagjen "Tophane" – 60 fëmijë



## Arsimi në shërbim të zhvillimit

- ✓ **Kifle dhe qumësht falas** për të gjithë nxënësit e klasave 1-5 dhe për nxënësit e klasave 6-9 në shkollat e përfshira në mësimin tërëditor;
- ✓ **Investim në pajisje shkollore për të lehtësuar çantat e fëmijëve** – Tashmë në të gjitha shkollat e komunës së Prishtinës janë vendosur dollapët për secilin fëmijë (klasat 1-5);
- ✓ **Përzgjedhja e drejtorëve me pjesëmarrje në komunitet**  
Drejtorja e Arsimit ka përgatitur dhe ka filluar aplikimin e formularëve standard për përzgjedhjen e stafit drejtues në institucionet edukativo-arsimore të nivelit parauniversitar. Përzgjedhja e mësimdhënësve dhe udhëheqësve të institucioneve edukativo-arsimore bëhet me përfshirjen e përfaqësuesve të keshillit drejtues, keshillit të prindërve, të komunitetit, shoqërisë civile dhe të ekspertëve të jashtëm;



- ✓ **Vlerësimi i punonjësve në bazë të kualifikimeve** në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit para universitar. Pas inspektimeve të bëra kemi gjetur se disa mësimdhënës nuk kanë pasur përgatitjen e duhur siç kërkohet me Ligjin e Arsimit të Lartë, Ligjin e Arsimit Parauniversitar dhe Udhëzimin Administrativ. Në përputhje me ligjet dhe udhëzimet administrative, 3 mësimdhënës janë risistemuar, duke pasur parasysh kualifikimet e tyre si për shembull nga shkolla fillore e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, për shkak të kualifikimeve jo përkatëse dhe 1 mësimdhënës është transferuar nga shkolla e mesme e lartë në të mesme



të ulët, për shkak të kualifikimit jo përkatës për shkollën e mesme të lartë. Ndërsa 7 mësimdhënësve të tjerë nuk iu është vazhduar kontrata e punës. 5 nga këta mësimdhënës kanë qenë të pranuar jashtë konkursit dhe kanë pasur përgatitje shkollore jo përkatëse për nivelin e mesëm të lartë, ndërsa 3 të tjerëve nga shtatori i vitit 2015, nuk iu është vazhduar kontrata, sepse njëri ka qenë mësimdhënës i matematikës, me përgatitje shkollore të mesëme, dhe tjetri mësues klasor me psikologji të përfunduar në kolegji të palicencuar;

- ✓ **Ngritja e cilësisë përmes procesit të regjistrimit të nxënësve në klasë të dhjetë (X)** - Duke respektuar me përpikëri kriteret e përcaktuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, kriteret e Drejtorisë së Arsimit dhe Udhëzimin Administrativ nr. 22/2013, numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës-nxënës, kemi ndikuar në përmirësimin e cilësisë së mëimit;



- ✓ **Trajnim për zhvillim profesional të personelit edukativ** në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe OJQ të ndryshme;
- ✓ **Funksionalizimi i këshillave drejtues në të gjitha shkollat e komunës së Prishtinës** Ministrinë e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe OJQ të ndryshme;



- ✓ **Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme shkollore**

Pajisja e 32 shkollave me kabinate mësimore të kimisë, biologjisë dhe fizikës;

Pajisja e 12 shkollave me biblioteka shkollore;

Përmirësimi i infrastrukturës në sallat e edukatës fizike të 9 shkollave;

Fillimi i projektit për rregullimin e oborreve të këtyre shkollave:

- SHFMU "Dardania" – në proces,
- SHFMU "Naim Frashëri" – në proces,
- SHFMU "Faik Konica" – në proces,
- SHFMU "Gjergj Fishta" – në proces,
- SHMFU "Nexhmi Mustafa" – në proces,
- SHFMU "Ismail Qemali" – Prishtinë (në proces, bashkëfinancim me Demos);

Fillimi i projektit për rregullimin e oborreve të këtyre çerdheve:

- "Ardhmënia" - është realizuar
  - "Dielli" – në proces,
  - "Yllkat" – në proces,
  - "Fatosat" – në proces,
  - "Xixëllonjat" – në proces,
  - "Buzëqeshja" – në proces,
  - "Gëzimi ynë" – në proces,
  - "Lulevera" – në proces;
- ✓ Ka filluar zbatimimi i **projektit për digjitalizimin e ditarëve** në 5 shkolla fillore dhe të mesme të larta.
- ✓ Ka filluar implementimi i **projektit të mësimit tërëditor** në 3 shkolla: "Model", "Faik Konica" dhe "Afrim Gashi";
- ✓ **Promovimin e leximit të fëmijët e shkollave fillore** – Në kuadër të projektit "PRISHTINA LEXON" përmes të cilit synojmë të nxisim dëshirën dhe të krijojmë shprehje të leximit tek fëmijët, për dy vite radhazi kemi organizuar kampanjën e leximit "Prishtina Lexon" dhe garën për "Përrallën më të bukur për Prishtinën". Duke e ditur se qëllimi i këtij projekti nuk mund të realizohet

vetëm përmes kampanjave dhe garave, kemi filluar investimet edhe nëpër shkolla, duke shndërruar këndet e pashfrytëzueshme nëpër shkolla në hapësira atraktive në **KËNDE TË LEXIMIT**. Këndet e leximit deri më tani janë realizuar në 12 shkolla:

- SHFMU "Dardania", lagja "Dardania",
- SHFMU "Naim Frashëri", lagjja "Aktash",
- SHFMU "Faik Konica", lagjja "Qendër",
- SHMFU "Nexhmi Mustafa", fshati Besi,
- SHFMU "Ismail Qemali", lagjja "Bregu i Diellit"
- SHFMU "Model", lagjja "Tophane"
- SHFMU "Afrim Gashi" – Hajvali
- SHFMU "Anton Zako Çajupi", fshati Bardhosh
- SHFMU "Elena Gjika", lagjja "Dodona"
- SHFMU "Hilmi Rakovica", lagjja "Kodra e Trimave"
- SHFMU "Hasan Prishtina", lagjja Ulpiana
- SHFMU "Xhavit Ahmeti", lagjja "Vreshta"







- ✓ **Hapja e tregut për bujqit vendorë** – Nga muaji nëntori i këtij viti, 1200 fermerë të komunës së Prishtinës dhe komunave përreth kanë filluar të shesin produktet e tyre tre herë në javë në nëntë lokacione të ndryshme në lagje të Prishtinës. Për herë të parë prodhuesit vendorë kanë hapësirë të sigurt, pa pagesë dhe të përshtatshme për të shitur produktet e tyre. Po ashtu, për herë të parë qytetarët kanë mundësi të blejnë produkte të sigurta vendorë. Në këtë projekt, në bashkëpunim me Zyrën e BE-së, janë investuar mbi **479,397.00 euro**;
- ✓ Lidhja në mes të institucioneve dhe grupeve të tjera në Prishtinë me prodhuesit vendorë **Përkrahja e fermerëve vendorë** për të ndihmuar në rritjen e prodhimeve të produkteve vendorë dhe zhvillimin ekonomik të Prishtinës;

Meliorimi i livadheve dhe kullosave	<b>140 fermerë</b>	<b>17,150.00 euro</b>
Përkrahja e fermerëve për mbjelljen e patateve	<b>67 fermerë</b>	<b>79,930.00 euro</b>
Përkrahja e fermerëve në perimtari-serra	<b>27 fermerë</b>	<b>201,000.00 euro</b>
Përkrahja e fermave në lëmin e shpeztarisë -pulave vojse	<b>18 ferma komerciale</b>	<b>119,520.95 euro</b>
Veterina mobile-vaksinimi i gjedheve dhe qenve shtëpiak si edhe mbarsim artificial i gjedheve		<b>53,756.00 euro</b>
Përkrahja e bletarëve në bletari	<b>282 bletarë</b>	<b>98,770.00 euro</b>
Përkrahja e fermerëve për mbjelljet vjeshtore-grurë	<b>819 fermerë</b>	<b>259,560.00 euro</b>
Përkrahja e fermerëve për ujitjen e kulturave bujqësore	<b>55 fermerë</b>	<b>40,672.00 euro</b>
Përkrahja e fermerëve për ngritjen e pemishteve me mjedër	<b>35 fermerë</b>	<b>91,000.00 euro</b>
Përkrahja e fermerëve në blegtori	<b>727 fermerë</b>	<b>257,464.00 euro</b>



## Vendosja e rregullit në planifikim urban

- ✓ Përfundimi i lëndëve të vjetra për leje ndërtimi;
- ✓ Ndalja e ndërtimeve pa leje;
- ✓ Procesi i legalizimit – Ka përfunduar regjistrimi i ndërtimeve pa leje dhe ka filluar faza e aplikimit për trajtim të tyre. Procesi është në vazhdim e sipër dhe do të përfundojë në afatin e paraparë;
- ✓ Publikimi i lejeve të ndërtimit në web-faqen e Komunës;
- ✓ **235 leje ndërtimi** – në vitin 2014 janë dhënë **84** leje ndërtimi, ndërsa në vitin 2015 janë dhënë gjithsej **151** leje ndërtimi;
- ✓ Publikimi i Udhëzuesit për qytetarë;
- ✓ Përfundimi i lëndëve me dokumente konkrete-kushte ndërtimi dhe leje ndërtimi brenda afatit ligjor;
- ✓ Zgjidhjet urbane që sigurojnë qëndrueshmëri të zhvillimit, i paraprijnë kushteve të ndërtimit për ndërtesat e kategorisë II - themelimi i grupit për zgjidhje urbane;
- ✓ Është hartuar Planit rregullues “Kodra e Trimave”, por nuk është shqyrtuar e miratuar nga Asambleja komunale;
- ✓ Është bërë revidimi i Planit rregullues “Arbëria III”, i cili është miratuar dhe ka hyrë në fuqi;
- ✓ Është bërë revidimi i Planeve rregulluese “Sofali” dhe “Kalabri” por nuk janë shqyrtuar e miratuar nga Asambleja Komunale;
- ✓ Avancimi dhe plotësimi i Permit Tracking System me lëndët në trajtim;
- ✓ Është bërë hartimi dhe miratimi i Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridikë;
- ✓ Në mënyrë të rregullt bëhet mbikëqyrja e projekteve që realizohen nga investimet kapitale të Komunës;
- ✓ Bashkëpunimi me qytetarë dhe kompani ndërtimi për të rregulluar dhe ndërtuar lagje moderne dhe të përbalueshme,





pranimin teknik për ndërtesat e pajisura me leje ndërtimi sipas Ligjit të vjetër të ndërtimit dhe mbikëqyrjet inspektuese sipas Ligjit të ri të Ndërtimit;

- ✓ Bashkëpunimi me qytetarë dhe UN-Habitat, për krijimin e hapësirave publike: dizajnimi i projektit ideor të parkut në lagjen "Kodra e Diellit";
- ✓ Procesi i legalizimit – Ka përfunduar regjistrimi i ndërtimeve pa leje dhe ka filluar faza e aplikimit për trajtim të tyre. Procesi është në vazhdim e sipër dhe do të përfundojë në afatin e paraparë;

me infrastrukturë teknike dhe sociale – "KODRINA", Mati I;

- ✓ Është lansuar **shërbimi online** për informata nga planet rregulluese;
- ✓ Publikimi i informatave për qytetarë në formë të posterëve - Infographics ,përkrahur nga UNDP-ja;
- ✓ Ftesa publike për të interesuarit për shprehje të interesit për t'u listuar në listën e inxhinierëve, për të bërë





## Hapja e komunës për qytetarë

- ✓ **Publikimi i rregullt i raporteve financiare** - Kemi arritur në fazën e fundit të lansimit të veprës **E-Shpenzimi**, ku qytetarët mund të përcjellin të gjitha shpenzimet që bën kryetari i Komunës dhe Komuna në përgjithësi;
- ✓ **Prokurimi transparent** – Është ofruar qasje e plotë në prokurim për shoqërinë civile dhe qytetarët;
- ✓ **Certifikata "online"** – Kemi filluar me shërbimin e shpejtë përmes internetit - për 48 orë certifikata arrin në shtëpi;
- ✓ **Zgjatja e orarit për ofrimin e shërbimeve komunale** - Është zgjatur orari i punës për Zyrën e Gjendjes Civile për shërbimet ndaj qytetarëve, prej 8:30 – 17:30 (e hënë – e premte), si dhe ditën e Shtunë orari është 9:00 – 12:00;
- ✓ **Sistemi i pritjes** – është instaluar sistemi



i pritjes, i cili ka përmirësuar shërbimet e Komunës, si dhe ka lehtësuar procesin e marrjes së dokumenteve personale dhe ka ulur kohën e pritjes nga 2-4 orë në më pak se 5 minuta. Tani për të gjitha dokumentet aplikohet, paguhet dhe vulosen në një sportel;

- ✓ **Sistemi i pritjes** është zgjeruar edhe në Drejtorinë e Kadastrit. Tani orari i punës për qytetarë të cilët aplikojnë për shërbime kadastrale në 5 zyrat pritëse, është nga ora 08:30 - 15:00,

çdo ditë pune. Zyrat pritëse kanë filluar të punojnë edhe gjatë pushimit të drekës, nga ora 12:00 - 13:00. Po ashtu, qytetarët tani mund të marrin edhe vërtetimin për tatimin në pronë në po të njëjtin vend, pa pasë nevojë të shkojnë në drejtori të pronës;

- ✓ **E-Kiosku** – Komuna e Prishtinës është ndër komunat e para në rajon me funksionalizimin e E-Kioskut. Përmes E-Kioskut qytetarët mund të pajisen me 5 certifikata të ndryshme, me çmim të njëjtë, në kohë shumë të shkurtër (2-3 min) shtatë ditë në javë për 24 orë;
- ✓ **Është lansuar qasja "online" e tatimit në pronë**
- ✓ Gjatë këtyre dy viteve kemi miratuar 97% të kërkesave për qasje në dokumentet publike në të cilat është dhënë përgjigje, dhe 3% të kërkesave kanë qenë të pa definuara mirë ose janë adresuar gabimisht në Komunën e Prishtinës, të cilat u janë ridrejtuar kërkuësve tek institucionet përkatëse. Numri i kërkesave për vitin 2014 ka qenë 172, ndërsa në vitin 2015 ka qenë 160;
- ✓ **Pajisja e punonjësve me uniformë** – të gjithë punonjësit janë të uniformuar dhe bartin ID kartelën, në mënyrë që të mund të identifikohen lehtë, nëse qytetari ka vërejtje;
- ✓ **Përgjigjet në ankesat e qytetarëve bëhen brenda afatit të paraparë me ligj**
- ✓ **Vulat në të gjitha bashkësitë lokale** – Qytetarët nuk kanë nevojë të vijnë për një vulë në Komunë;
- ✓ **Ofrimi i informacioneve të sakta për përfituesit e Skemës së asistencës sociale dhe largimi i taksës së pagesës prej 3 euro për familjen aplikuese për**





Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prist

**Vetë shërbeu**  
Posluži se sam - Self service

**24/7**

**SAS.** Kjo është arritur në bashkëpunim të ngushtë mes DKSHMS dhe Drejtorisë së Urbanizimit. Asnjë nga palët e Skemës së asistencës sociale nuk ka nevojë që të shkojë në zyrë të Komunës dhe të aplikojë, por e gjithë puna kryhet nga vetë punëtorët e QPS-së dhe kjo ka ndikuar jashtëzakonisht shumë tek përfituesit e SAS-it;

- ✓ **Kutitë e ankesave të qytetarëve hapen çdo muaj** – Kutitë e ankesave nga viti 2010, nuk janë hapur asnjëherë. Rregullorja për kutitë është miratuar në Kuvend dhe kutitë për herë të parë janë hapur në muajin gusht të vitit 2014, dhe që nga atëherë janë hapur dhe do të hapen çdo muaj;
- ✓ **Platforma e re për aplikim "online"** – Kjo formë e aplikimit lehtëson punën e qytetarit për nxjerrjen e dokumenteve. Tani qytetarët shënojnë vetëm numrin personal dhe përzgjidhet dokumenti që iu nevojitet;
- ✓ **Aplikim "online" për subvencione** - Platforma është në fazën e testimit dhe do të jetë gati në janar të vitit 2016. Ky sistem do të lehtësojë dhe t'i bëjë më efikase procedurat e aplikimit.
- ✓ **Faqja e re elektronike e Komunës** – Është dizajnuar dhe strukturuar në nivel më të lartë, por duke iu përmbajtur Udhëzimit administrativ për mirëmbajtjen e faqeve elektronike;
- ✓ **E-rekrutimi** – Transparencë e plotë në punësim - platforma e cila mundëson aplikim "online" për pozitat e lira në Komunë dhe përcjelljen e procesit të rekrutimit për aplikacionet e kandidatëve që kanë aplikuar dhe numrin e pikëve të arritura;
- ✓ Janë instaluar tabelat orientuese për qytetarë, për t'i informuar dhe drejtuar tek sportelet në Administratë, Kadastër, dhe Urbanizëm;
- ✓ Është bërë instalimi i pajisjes për **votim digjital në Kuvend** - Me këtë kemi eliminuar votimin me dorë, duke përmirësuar vendimmarrjen në

Kuvendin komunal

- ✓ Janë instaluar **sensorët për matjen e ndotjes së ajrit** në gjashtë pika kyçe të qytetit. Përveç parametrin aktual, do të pasqyrohet edhe norma e ndotjes së lejuar sipas rregulloreve të BE-së, në mënyrë që parametrat të krahasohen.

Parametrat që maten janë:

dioksidi i sulfurit (SO<sub>2</sub>), hidrogjensulfidi (H<sub>2</sub>S), dioksid i azoti (NO<sub>2</sub>), ozoni (O<sub>3</sub>), grimcat PM<sub>10</sub> edhe PM<sub>25</sub>, monoksidi i karbonit (CO), amoniaku (NH<sub>3</sub>), radioaktiviteti, decibel metër - matës i zhurmës dhe temperatura;





Sensorët janë vendosur në lagjet: "Bregu i Diellit" në rrugën "Enver Maloku", në lagjen "Dodona", rruga "Afrim Loxha", në lagjen "Dardania", rruga "Ilaz Kodra" në lagjen "Ulpiana", rruga "Mujë Krasniqi", në "Qendër" në sheshin "Zahir Pajaziti", dhe në lagjen "Kodra e Trimave", rruga "Vëllezërit Fazliu";

Të gjitha rezultatet për secilën pikë mund të lexohen në faqen elektronike të Komunës së Prishtinës;

- ✓ Është lansuar **dat baza e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike**

(kafenetë, hotelet, restorantet etj...). Nga këto të dhëna qytetarët informohen për emrin e lokalit, pronarin, destinimin, sipërfaqen totale, hapësirat e brendshme, hapësirat e jashtme, vlershmërinë dhe afatin e lejes. Kjo na ndihmon të kuptojmë në çdo moment se kujt i skadon leja dhe kush e shfrytëzon objektin;





## Barazi në Prishtinë

- ✓ **Programi për integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla dhe çerdhe**– Është krijuar ekipi vlerësues profesional për fëmijë me nevoja të veçanta i cili do të kujdeset që të bëhet integrimi dhe monitorimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet edukativo-arsimore, si dhe rekomandimi për adresim më efektiv të problemeve. Numri i fëmijëve të integruar është **328 fëmijë** ( 32 fëmijë te integruar në çerdhe, ndërsa 296 në shkolla fillore dhe të mesme);
- ✓ Komuna e Prishtinës gjatë kësaj periudhe ka ngritur shumën e mjeteve për t’iu dalë në ndihmë familjeve me gjendje të rëndë ekonomike. Në vitin 2014, Komuna ka ndarë **50 mijë euro** të kursyera gjatë vitit me subvencione, për rastet më të rënda sociale;
- ✓ **Programi për qasje në institucionet publike për personat me nevoja të veçanta** – Gjatë këtyre dy viteve është bërë përmirësimi i infrastrukturës për lëvizje të pakufizuar dhe qasje më të lehtë në të gjitha institucionet publike komunale. Të gjitha projektet që kanë filluar dhe përfunduar gjatë viteve 2014 dhe 2015, janë punuar sipas standardeve të kërkuara për bërjen e Prishtinës qytet të qasshëm për të gjithë qytetarët.  
Në fillim të vitit 2015, në zonën “Qendër” është bërë identifikimi i pengesave në lëvizjen e lirë të personave me nevoja të veçanta në trotuare, vend-kalime për këmbësorë, sheshe, hapësira publike dhe parkingje. Po ashtu janë bërë vizita nëpër banesat kolektive, ku banojnë personat me nevoja të veçanta, në institucionet shtetërore, lokale, spitale e qendra të mjekësisë familjare dhe shkolla dhe pas kësaj janë bërë projektet për intervenime në tri lagje të Prishtinës, në lagje: “Dardania”, “Kodra e Diellit” dhe “Ulpiana”;

Janë identifikuar institucionet shtetërore, lokale, spitale e qendra të mjekësisë familjare dhe shkolla, ku nevojat për intervenim janë imediate për instalimin e ashensorëve;

Është bërë **instalimi i dy ashensorëve në QKMF dhe QMF -VI**, për qëllim të lehtësimit të marrjes së shërbimeve shëndetësore nga individët me nevoja të veçanta;

Është në proces **instalimi i ashensorit panoramik të jashtëm në objektin e vjetër të Komunës** – Është përzgjedhur kompania dhe kanë filluar punimet. Ashensori do të jetë i gatshëm në muajt e parë të vitit 2016. Ky ashensor do të mundësojë qasje të lehtë në të gjitha katet e ndërtesës të gjithë personave, e posaçërisht personave me nevoja të veçanta, nënave me karroca dhe personave të moshuar;

Është në proces **Instalimi i ashensor-platformës** – Do të jetë e gatshme për përdorim në fillim të vitit 2016. Ky ashensor do t'iu mundësojë qasje të lehtë të gjithë personave me nevoja të veçanta, nënave me karroca dhe



personave të moshuar në ofiqari dhe sportele të tjera që gjenden në katin e parë;

- ✓ **Lirimi nga pagesa për shërbime komunale të rasteve sociale dhe grupeve të rrezikuara**- Në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale (QPS), rastet sociale janë liruar nga pagesa e taksës prej tre (3) eurove nga Drejtoria e Kadastrit. Me një bashkëpunim me QPS-në, palët tani aplikojnë drejtpërdrejtë në QPS, ndërsa ne si drejtori në baza javore dërgojmë raport në lidhje me posedimin / mos posedimin e pronave të paluajtshme të aplikuesve për asistencë sociale, drejtpërdrejtë në QPS;
- ✓ **Programi i integritit të personave me nevoja të veçanta në vendet e punës** – Në muajin nëntor 2015, në pozitën e telefonistit është punësuar një person me nevoja të veçanta (i verbër). Po ashtu, në kuadër të programit është organizuar " Muaji i mundësive të barabarta profesionale për persona me nevoja të veçanta" ku iu është mundësuar 10 personave me aftësi të kufizuar të jenë pjesë e stafit për dy ditë në drejtori të ndryshme të Komunës.
- ✓ **Krijimi i kushteve dhe mundësive për pjesëmarrje të rinjve me nevoja të veçanta në aktivitetet kulturore dhe sportive** të organizuara nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, siç ishte pjesëmarrja e Shoqatës së të Shurdhërve me aktivitetin "Prishtina me valle" në festivalin "Ylberi i Prishtinës".

**Lirimi nga pagesa për shërbime komunale për rastet sociale dhe grupet e rrezikuara**





## Shëndeti në shërbim të zhvillimit

- ✓ Vizita të rregullta sistematike mjekësore e stomatologjike në të gjitha shkollat për klasat 1 , 5 dhe 9
- ✓ Zonimi i qytetit: çdo banor ka mjekun e vet.

Distribuími racional i stafit shëndetësor në vendet ku ka më shumë nevojë.

---

Përcaktimi i nevojave për procesin e digjitalizimit dhe analiza e ndarjeve zonale.

---

Furnizimi me pajisje dhe lidhja me internet i të gjitha institucioneve shëndetësore në komunën e Prishtinës, si domosdoshmëri për proces të digjitalizimit.

---

- ✓ Instalimi i aparaturave për monitorimin e orarit të punës.
- ✓ Instalimi dhe funksionalizimi i sistemit digjital "PARATUS" në Qendrën e Mjekësisë Urgjente, që digjitalizon përmes tabletëve dhe hartave të para-instaluar, shërbimet urgjente në terren, duke lidhur terrenin me Qendrën e Mjekësisë Urgjente dhe Qendrën

Emergjente në QKUK, për të shkurtuar kohën e veprimit.

✓ **Sistemi i informimit në shëndetësi, secili banor ka kartelën e vetë digjitale**

Hapja e faqes elektronike në QKMF, si hap i parë i informimit mbi shërbimet dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore <http://qkmf-pr.org/>.

Instalimi i sistemit të menaxhimit të radhës në njësitë laboratorike. Në këtë drejtim ka filluar edhe harmonizimi i aparaturave me këtë sistem, duke instaluar aparatet digjitale që lidhen me sistemin e digjitalizimit, si rëntgeni digjital, aparatet laboratorike, EKG-të e të tjera.

✓ **Shërbime të patronazhit, vizita për pacientët në nevojë nëpër shtëpitë e tyre**

Ngritja e kapaciteteve në resurse humane, ku janë pranuar punëtorë shëndetësor shtesë për këtë shërbim.

Pajisja e të gjithë punëtorëve në shërbim të patronazhit me aparaturën dhe materialin e nevojshëm për shërbime cilësore shëndetësore.

Proces-blerja e 3 automjeteve për funksionalizimin e 3 ekipeve operuese të vazhdueshme për këtë shërbim.

✓ **Dezinsektimi** - Procesi i dezinfektimit për herë të parë i realizuar në mbi 6,000 hektarë dhe në 5 faza, ku janë përfshirë edhe fshatrat e komunës së Prishtinës dhe rajone problematike me insekte





# Prishtina e sigurtë

- ✓ **Zgjerimi, mirëmbajtja dhe modernizimi i rrjetit të vjetërsuar të ndriçimit publik** – Kemi bërë zgjerimin e ndriçimit publik në 129 rrugë në lagje të ndryshme të Prishtinës. Rrugët ku është bërë zgjerimi janë:



## Rrugët ku është bërë zgjerimi i ndriçimit gjatë viti 2014, janë:

rr. "Muharrem Fejza"; Matiçan te qezma; rr. "Behgjet Brajshori", Hajvali; rr. "Tepelena", Hajvali; rr. "Dëshmorët e Gollakut", Hajvali; rr. "Brigada 153", Hajvali; rr. "ODA", Hajvali; rr. "Tetova", Hajvali; rr. "Dëshmorët e Gollakut", Hajvali; rr. "Ulzat", Hajvali; rr. "Tom Llantosh", Hajvali; rr. "Arbanasët", Hajvali; rr. "Shkëndija", Hajvali; Prugofci II; Vranidoll i Poshtëm II; rr. "Mentor Retkoceri"; rr. "Ahmet Delia"; rr. "Xhelal Hajda"; rr. "Esat Berisha"; rr. "Nesret Krasniqi"; rr. "Jashar Erebara"; rr. "Nasjet Selimi"; rr. "Ernest Zariqi"; rr. "Viktor Hygo"; rr. Jan Kukuzeli"; rr. "Xhemajl Ahmeti"; rr. "Lidhja e Prizrenit"; rr. "Musine Kokollari"; rr. "Enver Xherxheku"; rr. "Shëndeti"; rr. "Hamit Haxhia"; rr. "Murat Xhakla"; rr. "Haxhi Zeka"; rr. "Çeta e Llapit"; rr. "27 Nëntori"; rr. "Holger Petersen"; rr. "Mulla Zekë Bërdynaj"; rr. "Hysen Terpeza"; rr. "Nail Hyseni"; rr. "Nazim Hikmet"; rr. "Halim Spahia"; rr. "Dëshmorët e Sharrit"; rr. "Qorr Ilazi"; rr. "Vëllezërit Rama"; rr. "Ismet Bicaj"; rruga pa emër II; rr. "Fadil Bala"; rruga pa emër I; rr. "Shaban Shala"; rr. "Shaban Shala" (pa emër I); rr. "Asdreni"; rr. "Marin Barleti"; rr. "Rexhep Krasniqi" (pa emër I); rr. "Xhon Muzaka"; rr. "Rexhep Krasniqi" (pa emër II); rr. "Shefqet Shkupi"; rr. "Rexhep Krasniqi" (pa emër III); rr. "Hasi"; rr. "Selami Musai"; rr. "Rasti Social"; Lakërishtë; rr. "Tirana"; shkolla "Xhemajl Mustafa" –parking; rr. "Dritan Hoxha" –Pallati i Rinisë; rr. "Rexhep Luci" – parking; rr. "Hajdar Dushi" –parking; rr. "Selami Pulaha", rr. "Xhevat Qena"; rr. "Fehmi Lladrofc";

## Zgjerimi, mirëmbajtja dhe modernizimi i rrjetit të vjetërsuar të ndriçimit publik - zgjerimi i ndriçimit është në proces në rrugët:

rr. "Ibrahim Krasniqi"; rr. "Ernest Zariqi"; rr. "Mehmet Beci"; rr. "Stefan Mokranjac"; rr. "Dervish Cara"; rr. "Ismet Asllani"; rr. "Ohri"; rr. "Dervish Shaqa"; rr. "Ali Pashë Gucia"; rr. "Ndre Mjeda"; rr. "Vehbi Ibrahim"; rr. "Marije Shllaku"; rr. "Xheladin Deda"; rr. "27 Nëntori"; rr. "Rifat Kraniqi"; rr. "Afrim Krasniqi"; rr. "Albaniku"; rr. "Kamer Loshi"; rr. "Jetullah Islami"; rr. "Doktorëve"; rr. "Viktor Eftimiu"; rr. "Shyt Mareci"; rr. "Bastri Canolli"; rr. "Papa Kristo Negovani"; Hekurrudha Industriale (Emshir); rr. "Shaip Mustafa"; rr. "Ali Ajeti"; rr. "Sali Nivica"; rr. "Nobert Jokl" (një pjesë); rr. "Hakif Rimanishta"; rr. "Sali Xhuka"; rr. "Ymer Prizereni"; rr. "Isa Kastrati I"; rr. "Isa Kastrati II"; rr. "Malush Kosova"; rr. "Mulla Zekë Bërdyna"; rr. "Liria"; rr. "Lec Gradica"; rr. "Isa Kastrati" (lidhëse mbrapa Milleniumit); rr. "Përroi i njelmët"; rr. "Dëshmorët Konusheci"; rr. "Struga"; rr. "Petro Marko"; rr. "Tomori"; rr. "Preveza"; rr. mbrapa Shkollës Normale; rr. "Dr. Shpëtim Robaj"; rr. "Dëshmorët e Marecit"; rr. "Agim Çela"; rr. "Xhavit Ahmeti"; rr. "Luan Haradinaj"; rr. "Ekrem Rexha"; lagjja "Veternik"; në Qendrën e Mjekësisë Familjare, Mati 1 (shkolla fillore "Pavarësia" dhe rruga lidhëse); në parking te Santea, "Dardani", në parking te Termokosi; në parking dhe parku i vjetër "Dardani"; në parkingjet e lagjes "Ulpiana", në shkollat e Prishtinës, Shala e Bajgorës, Beteja e Kosharës, Tabet e Llapashticës;



Zgjerimi i ndriçimit është duke u bërë edhe në **10 fshatra të komunës së Prishtinës**: Besi, Prugoc I, Bardhosh, Pjesa II Lebanë (Berbatovc), Shashkoc, Sharban, Zllatar, Dabishec, Rimanishtë, dhe Grashticë.

✓ **Vendosja e matësve të shpejtësisë së automjeteve afër shkollave për të përmirësuar sigurinë** – Matësit e shpejtësisë janë vendosur afër shkollave dhe në rrugët ku rrezikshmëria është cilësuar të jetë më e lartë; pranë shkollave fillore dhe të mesme: *“Model”*, *“Ismail Qemali”*, *“Hoxhë Kadri Prishtina”*, rr. *“Enver Maloku”* afër shkollës fillore *“Ismail Qemali”*, lagjja *“Kodra e Diellit”*, rr. *“Tahir Zajmi”*, lagjja Kalabri, rruga *“Zagrebi”*, lagjja *“Tophane”*.

Ndërsa janë në proces dhe do të përfundojnë në vitin **2016**:

rr. *“Nazim Gafurri”* afër shkollës *“Gjergj Fishta”*, lagjja *“Taukbahqe”*, rr. *“Dr.Shpëtim Robaj”* afër shkollës *“Gjin Gazulli”*, lagjja *“Sofalia”*, rr. *“Isa Kastrati”* afër shkollës *“Mitrush Kuteli”*, lagjja *“Mati”*, rr. *“Isa Kastrati”* afër shkollës *“Iliria”*, lagjja *“Kodra e Diellit”*, rr. *“Lidhja e Prizrenit”* afër shkollës *“Meto Bajraktari”*, lagjja *“Tophane”*, dhe rr. *“Ilir Konushevc”* afër shkollës *“Emin Duraku”*.

✓ **Ngritja e vendkalimeve dhe vendosja e pengesave në rrugë për të përmirësuar sigurinë** – Janë bërë në vendet më të frekuentuara të qytetit dhe afër shkollave të qytetit.

## Ngritja e vendkalimeve është bërë në këto rrugë:

*“George Bush”*, *“Luan Haradinaj”*, *“Fehmi Agani”*, *“Enver Maloku”*, *“Lidhja e Prizrenit”* (afër shkollës *“Meto Bajraktari”*), *“Lidhja e Prizrenit”* (afër shkollës së Gjelbër), afër shkollës *“Eqrem Çabej”*, *“Vëllezërit Fazliu”* (afër shkollës *“Asim Vokshi”*).

## Vendosja e pengesave është bërë në këto rrugë:

*“Hamdi Gashi”* Velania, *“Ahmet Krasniqi”* Arbëria (3 pengesa), *“Zagrebi”* Arbëri (2 pengesa), *“Carraleva”*, *“Bajram Bahtiri”* afër Medresesë, *“Ardian Krasniqi”* në lagjen e Muhaxherëve, *“Vëllezërit Fazliu”* Kodra e Trimave, *“Hyzri Talla”* Kodra e Trimave, *“Mic Sokoli”*, *“Kodra e Trimave”*, *“Haxhi Zeka”*, *“Dr.Shpëtim Robaj”* Sofali (2 pengesa), *“Idriz Gjilani”* Dardania (2 pengesa), *“Imzot Nikprela”* Ulpianë (3 pengesa), *“Isa Kastrati”* Kodra e Diellit, *“Isa Kastrati”* lagjja Dodona, *“Asllan Pirreva”*, Kodra e Trimave, *“Rexhep Shema”*, *“Rasim Kiçina”*, *“Rilindja”* Veternik,



*“Dëshmorët e Gollakut”* Hajvali, *“Dëshmorët e Marecit”* Velani, *“Gucia”*, *“Malush Kosova”* lagjja e Spitalit, *“Luan Haradinaj”* Qendër, *“Xhorxh Bush”* Qendër, *“Fehmi Agani”* Qendër, *“Vëllezërit Fazliu”* Kodra e Trimave, *“Lidhja e Prizrenit”* Tophane (3 pengesa), *“Remzi Salihu”* afër Medresesë, *“Enver Maloku”* Kodra e Diellit, *“Gazmend Zajmi”* lagja e Muhaxhirëve, *“Gjergj Balsha”* Arbëri, *“Arkitek Karl Gega”* lagja e Muhaxhirëve dhe *“Nëntori”* Dardani.

Ndërsa janë në proces në rrugët: rr. *“Ismajl Domoshi”* Taukbahqe afër shkollës





"Gjergj Fishta", rr. "Mic Sokoli" afër shkollës "Zenel Hajdini", Kodra e Trimave, rr. "Bajram Bahtiri" afër shkollës "Nazim Gafurri" Gjinaj, rr. "Idriz Gjilani" afër shkollës "Xhemajl Mustafa" Dardani, rr. "Ilaz Kodra" afër shkollës "Dardania" Dardani, rr. "Zija Shemsiu" afër shkollës "Hasan Prishtina" Ulpianë, rr. "Ibrahim Lutfiu" lagjen Velusha, rr. "1 Tetori" Velani, rr. "Bill Kinton" Lakërishtë, rr. "Xheladin Hana" dhe "Zenel Salihu".

## Lirimi i trotuareve – deri më tani masat anti-parking janë vendosur në mbi 35 rrugë:

"Xhorxh Bush" (89 shtylla), "Qamil Hoxha" (142 shtylla), "Rexhep Luci" (346 shtylla), "Ilir Konusheci" (158 shtylla), "UÇK-së" (365 shtylla), "Luan Haradinaj" (140 shtylla), "Fehmi Agani" (231 shtylla), "Idriz Gjilani" (18 shtylla), "Bill Klinton" (125 shtylla), "Tirana" (251 shtylla), "Agim Ramadani" (119 shtylla), "Ardian Krasniqi" (103 shtylla), "Eqrem Çabej" (133 shtylla), "Fazli Grajqevci" (58 shtylla),

"Fehmi Lladrovci" (58 shtylla), "Ibrahim Lutfiu" (43 shtylla), "Xhorxh Bush" (186 shtylla), "Qamil Hoxha" (315 shtylla), "Sylejman Vokshi" (24 shtylla), "Fehmi Agani" (287 shtylla), "Ilaz Kodra" (858 shtylla), "Perandori Justinian" (248 shtylla), "Dëshmorët e Kombit" (186 shtylla), "Fehmi Lladrovci" (105 shtylla), "Dr. Shpëtim Robaj" (51 shtylla), "Rruga B" (28 shtylla), "Muahrrem Fejza" (18 shtylla), "Armend Daci" (89 shtylla), rruga te Stacioni i Autobusëve (15 shtylla) dhe rruga te rrethi i ri (25 shtylla) - rrugë që lidhin rrugët "Magjistrale M2", Mitrovicë, Ferizaj dhe Shkup, "28 Nëntori" (48 shtylla), pllatoja Kurriz (31 shtylla), "Enver Maloku" (12 shtylla), rruga "Fatmire Sokoli" Kalabri (16 shtylla) "Arkitek K.Gega" (30 shtylla).

## Ndërsa janë në proces rrugët:

"Dëshmorët e Kombit" (498 shtylla), "Eqrem Çabej" (65 shtylla) "Ilir Konusheci" (178 shtylla), "Hyzri Talla" (566 shtylla), "Tirana" (213 shtylla), "Ibrahim Lutfiu" (264 shtylla), "Bajram Bahtiri" (105 shtylla).

# Furnizim i pandërprerë me ujë për 24 muaj

**Vlerësimi i humbjeve** – në proces – Ka përfunduar raporti për burime alternative. Mbetet përfundimi i raportit për distribucion. Ujësjetësi Regjional "Prishtina" ka zëvendësuar gypat e ujit në një pjesë të madhe të qytetit. Ujësjetësi Regjional "Prishtina" filloi ndërtimin e fabrikës së re të ujit, më 10 nëntor 2014.

Problem kryesor mbeten kompetencat e përziera, ku nuk merret plotësisht përgjegjësia

**Plani i investimeve kapitale** – Ka përfunduar për burime, ndërsa është në proces për distribucion (rrjet).

**Realizimi i investimeve** - në proces, pritet të realizohen në vitin 2016.

Kompania e ujësjetësit regjional "Prishtina" edhe më tutje vazhdon të sfidohet nga rrjetet e ndryshme politike, të cilat edhe e kanë sjellë në këtë gjendje. Bordi i ndërmarrjes KUR "Prishtina" gjatë vitit shkarkoi drejtorin ekzekutiv z. Gjelo Vataj, dhe si rezultat filloi të përmirësohet puna dhe marrëdhëniet me Komunën e Prishtinës. U dakordua dinamika e punëve dhe filluan punimet edhe në fabrikën e ujit. Komuna e Prishtinës e mirëpriti edhe procesin e përzgjedhjes së bordit, ku Komuna e Prishtinës do ta kishte një anëtar, mirëpo Qeveria e Republikës së Kosovës, në kundërshtim me ligjin, anashkaloi propozimin e Komunës dhe përzgjedhi një anëtar bordi nga një komunë tjetër. Në mbledhjen e parë të bordit të ri u shkarkua drejtori i ri, dhe në post u kthye drejtori i kaluar i cili është një ndër përgjegjësit kryesor për gjendjen e rëndë të furnizimit me ujë. Komuna ka dërguar tashmë letra tek të gjitha institucionet, se kjo gjendje është e papranueshme andaj Komuna do ta refuzojë bashkëpunimin me ndërmarrje publike të politizuara dhe të kapura nga pushteti.

## Rregullimi i trafikut në Prishtinë

**Reformimi i transportit publik** – Tashmë ka filluar reforma në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Zhvillim në një program mbi 10 milionë euro, ku ka përfunduar:

Vlerësimi teknik dhe ambiental - në bazë të këtij raport është bërë përzgjedhja e llojit të autobusëve që përshtaten me kushtet infrastrukturore dhe ambientale të Prishtinës

Gjatë vitit është hapur tenderi ndërkombëtar, është bërë hapja e ofertave, ku 4 kompani ndërkombëtare kanë aplikuar për furnizimin e Prishtinës me 51 autobusë, dhe është përzgjedhur kompania që do ta furnizojë Prishtinën me këta autobusë të ri. Pra, Komuna së bashku me BERZH ka përfunduar prokurimi i autobusëve të rinj.

Në pjesën e parë të vitit 2016, do të vazhdohet me planin e mobilitetit, do t'i caktojë linjat e reja dhe do të finalizohet projekti për sistemin e integruar të biletave.

**Themelimi i kompanisë publike** "Parking Prishtina" – Ka kaluar në Kuvendin komunal, i gjithë dokumentacioni është dorëzuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik për miratimin e themelimit të ndërmarrjes. Gjithashtu janë bërë të gjitha përgatitjet teknike dhe operative për fillimin e punës së ndërmarrjes për rregullimin e parkingut në zona publike në Prishtinë. Implementimi do fillojë në çerekun e parë të vitit 2016 përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike, meqë themelimi i ndërmarrjes po bllokohet nga niveli qendror. Zonimi për parking – Zona I dhe zona III kanë dhe zona III përfunduar, ndërsa zonimi i lagjeve do bëhet gjatë vitit 2016. Ka përfunduar realizimi i projektit për vendparkingjet përgjatë bulevardit

"Dëshmorët e Kombit", rrugët "Perandori Justinian", "Afrim Zhitia", "Hyzri Talla" (lagjja "Bregu i Diellit"), ndërsa në rrugët "Migjeni" dhe "Fehmi Agani" është bërë përcaktimi i vendparkingjeve për operatorët taxi. Në rrugët: "Sylejman Vokshi", "UÇK", "Ilaz Kodra", "Robert Doll", "Zija Shemsiu", "Lorenc Antoni", tek Pallati i Rinisë, pranë hyrjes së QKUK-së, projektet e vendparkingjeve janë në fazën e implementimit.

**Transport falas për pensionistët** – Tashmë dy vjet Komuna ka siguruar transportin falas për pensionistë - në linjat 3 dhe 4. Pas fillimit të operimit me autobusë të rinjë dhe krijimit të linjave të tjera pensionistët do të kenë mundësi të udhëtojnë edhe në linja tjera urbane.







# Vendimmarrja në lagje

## **Funksionalizimi i bashkësive lokale**

Në bashkëpunim me Demos, kemi filluar procesin e funksionalizimit të bashkësive lokale. Deri më tani kemi bërë projekt rregulloren, e cila iu është prezantuar të gjithë kryetarëve të bashkësive lokale. Pastaj kryetarët e Bashkësive Lokale kanë prezantuar këtë projekt rregullor tek këshillat e lagjeve dhe fshatrat dhe i kemi mbledhur të gjitha komentet e tyre. Kjo është bërë për herë të parë në Republikën e Kosovës, ku Komuna e Prishtinës ka konsultuar të gjithë faktorët relevantë për të shkruar rregullore, jo si më parë, apo siç praktikohet ende në komunat e tjera, të miratohet rregullorja në Kuvendin komunal pa i pyetur fare faktorët relevant t'u prezantohet si rregullore e përfunduar dhe e miratuar.

Për shkak të bllokimeve në Kuvend, nuk kemi arritur të krijojmë komisionin nga përfaqësuesit e të gjitha partive politike dhe ta prezantojmë rregulloren për miratim të projektit final. Pas miratimit të rregullores në Kuvend, do të organizohen zgjedhjet e reja për këshillat e bashkësive lokale

**Këshillat e lagjeve** – Në rregulloren për funksionimin e bashkësive lokale janë paraparë edhe përzgjedhja dhe formimi i këshillave në lagje, por i tërë procesi ka ngecur për shkak të bllokimit të Kuvendit të Komunës.

**Tubimet në lagje** – Proces i vazhdueshëm – Gjatë këtyre dy viteve, Komuna e Prishtinës ka mbajtur 94 diskutime publike për çështje të ndryshme me banorë të lagjeve dhe fshatrave të komunës së Prishtinës.



## Banim i përballueshëm

Banimi i përballueshëm do të zhvillohet si program në vitet **2016 – 2017**. Tashmë janë bërë përgatitjet dhe shumë shpejtë do të prezantohet politika.

## Reformimi i tatimit në pronë

**Reformimi i tatimit** në pronë është projekt nga i cili do të përfitojnë qytetarët me standard më të ulët ekonomik. Shkallët e reja të tatimit në pronë do të bëhen sipas gjendjes materiale dhe numrit të banorëve në objektet banesore. Deri më tani kemi arritur të realizojmë:

Me rregulloren e re të tatimit në pronë është bërë reformimi i tatimit në pronë, ku baza tatimore është ndryshuar, duke u përafëruar me vlerat e tregut. Tanimë lagjet ku pronat janë më të shtrenjta, do

të paguajnë më shumë tatim në pronë, ndërsa ato të cilat janë në gjendje më të rëndë socio-ekonomike dhe kanë vlera më të ulëta të pronave, do të paguajnë më pak. Tatimi në pronë do të jetë më i drejtë. Pra, lagjet me standard më të lartë të mirëqenies do të bartin barrën më të madhe nga shuma e përgjithshme e arkëtimit të tatimit në pronë. E tëra e harmonizuar me dokumentin e reformimit-analizës së tatimit në pronë

Përtej premtimeve...

---

# Përmirësimi i infrastrukturës lokale dhe zgjidhja e kontesteve shumëvjeçare

Duke filluar nga viti 2014, të gjitha investimet që janë bërë deri më tani, janë bërë sipas projekteve, ndryshe prej viteve të tjera, ku shumica e investimeve janë bërë në mungesë të projekteve. Gjatë dy viteve (2014-2015) kemi përfunduar projektimin e afër **100 rrugëve** dhe projektimin e **20 kanalizimeve** në fshatra e lagje të komunës. Kemi projektuar edhe **mure mbrojtëse** dhe **ura në fshatra**:

- ✓ Zhblokimi dhe përfundimi i punëve të rrethrotullimi në Veternik;
- ✓ Zhblokimi dhe përfundimi i punëve të rrethi i lagjes "Arbëria";
- ✓ Largimi i kundërmimit nga sheshi "Nëna Terezë";
- ✓ Trajtimi fizik dhe estetik i disa rrugëve të kryeqytetit, si: rrugët "*Rexhep Luci*", "*Garibaldi*", "*Qamil Hoxha*", "*Dëshmorët e Kombit*";
- ✓ Trajtimi i trotuarit dhe mbjella e fidanëve në rrugët: "*Imzot Nikë Prelaj*", "*Perandori Justinian*", "*Sylejman Vokshi*", "*Tringë Smajli*", "*Eqrem Çabej*" dhe "*Fehmi Agani*";
- ✓ Rindërtimi i 12 rrugëve me asfalt dhe kubëza në lagjen "Mati";
- ✓ Ndërtimi i rrugës "*Vlora*";
- ✓ Ndërtimi i rrugës "*Stambolli*" (faza e parë);
- ✓ Ndërtimi i rrugës "*Enver Maloku*" (faza e dytë);
- ✓ Ndërtimi i rrugës Siqevë-Sharban;
- ✓ Ndërtimi i rrugës Bërnice e Epërme - Sharban;
- ✓ Sanimi i 10 rrugëve me zhavorr;
- ✓ Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "*Jusuf Gërvalla*" - me 5 krahët e saj;
- ✓ Asfaltimi i rrugës në Hajvali;
- ✓ Ndërtimi i 7 rrugëve në lagjen "Kalabria";
- ✓ Vazhdimi i rrugës paralele me rrugën Prishtinë - Shkup;
- ✓ Ndërtimi i rrugës Slivovë - Dragovc;
- ✓ Ndërtimi i rrugës "*Malush Kosova*" – faza III;
- ✓ Ndërtimi i rrugës "*Mbretëresha Teutë*" dhe krahët e saj në anën e djathtë;
- ✓ Ndërtimi i 21 rrugëve me kubëza betoni në lagjen "Mati 1";
- ✓ Asfaltimi i rrugës dhe ndërtimi i murit mbrojtës në lagjen "Bërbatovc" në Barilevë;
- ✓ Asfaltimi i rrugës në fshatin Besi dhe trotuari në fshatin Milloshevë;
- ✓ Ndërtimi i rrugës Prishtinë - Sinidoll - Bërnice e Epërme - Bardhosh (faza e parë);
- ✓ Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "*Shaqir Igrishta*" dhe 23 rrugë lidhëse;
- ✓ Ndërtimi i rrugës "*Enver Maloku*"(krahu i dytë djathtas);
- ✓ Ndërtimi i rrugës nga rruga magjistrale Prishtinë - Gjilan (krahu i djathtë të pompa e benzinës "Mili Petrol 2 ") në Hajvali;
- ✓ Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës-drejtimi i Veternikut (pjesa e parë);
- ✓ Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës (drejtimi i Veternikut pjesa e tretë);
- ✓ Rregullimi i rrugës dhe kanalit të jashtëm të shkollës së mesme "*28 Nëntori*";
- ✓ Rindërtimi i rrugëve "*Remzi Demolli*", "*Mihajlo Pupin*", "*Zijaver Vllasaliu*" dhe

- krahët e rrugës;
- ✓ Ndërtimi i rrugës *"Naser Hajrizi"*;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës *"Stanbolli"* (faza II);
  - ✓ Ndërtimi i rrugës te parku në lagjen " Arbëria";
  - ✓ Mbulimi i Xhamisë së Çarshisë;
  - ✓ Ndërtimi i kanalizimit fekale në rrugën *"Mbretëresha Teutë"*;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës *"Basri Canolli"*;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës *"Gallapi"* –Prishtinë
  - ✓ Ndërtimi i rrugës *"Xheladin Kurbaliju"*
  - ✓ Ndërtimi i rrugës *"Esat Mekuli"*
  - ✓ Ndërtimi i rrugës prej rrugës së Mramorit deri te Pylli i Ariut-Badovc;
  - ✓ Ndërtimi i infrastrukturës në 10 rrugë të lagjes "Kalabria";
  - ✓ Ndërtimi i rrugës Llukar-Siqevë;
  - ✓ Sanimi i gropave dhe deformimeve të shtresave të asfaltit në rrugët dhe trotuaret e qytetit
  - ✓ Ndërtimi i rrugës paralele me rrugën "B"
  - ✓ Ndërtimi i rrugës Breznicë - Barilevë;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës *"Hasan Remniku"* - Kolovicë;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës Bërnice e Poshtme - M2;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës në fshatin Dabishevc, lagjet "Hasimi" dhe "Babiq";
  - ✓ Ndërtimi i rrugës në Koliq-lagjja Peraj;
  - ✓ Ndërtimi i rrugëve në Hajkobillë – 9 rrugë;
  - ✓ Ndërtimi i infrastrukturës në lagjen e Ramabajve - Hajvali;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës në Rimanishtë - Vranidoll;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës Koliq - Keqekollë";
  - ✓ Ndërtimi i infrastrukturës në rrugët *"Mirko Gashi"* dhe *"Gazë Përgjeni"*;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës Keqekollë - Nishec;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës *"Mithat Frashëri"*;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës lokale në lagjen "Sylaj" Busi, fshati Mramor;
  - ✓ Ndërtimi i murit mbrojtës në Rimanishtë, me gjatësi L=110m;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës Matiqan-Butovc-Kolovicë;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës Sharban-Koliq;
  - ✓ Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Shashkovc – 10 rrugë me asfalt;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës pranë sistemit "Ibër Lepenc"-Bërnice e Poshtme;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni-lagjja "Vakovc" (Marevc);
  - ✓ Ndërtimi i rrugës në fshatin Koliq-lagjja "Bushovit";
  - ✓ Ndërtimi i rrugës në fshatin Koliq lagjja "Sheqiraj" dhe ndërtimi i rrugës në fshatin Grashticë, lagjja "Kopranët";
  - ✓ Ndërtimi i rrugës lidhëse me rrugën *"Isa Kastrati"* në lagjen "Mati 1" rrua K3-2;
  - ✓ Ndërtimi i infrastrukturës në Veternik – 8 rrugë;
  - ✓ Rikonstruktimi i rrugës rr.*"Luan Haradinaj"*;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës *"Mitat Frashëri"*;
  - ✓ Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "Butrinti"-lagjja "Gjinaj";
  - ✓ Ndërtimi i rrugës në fshatin Llukar-lagjja "Obzovik";
  - ✓ Ndërtimi i parkingjeve dhe trotuareve në bulevardin *"Dëshmorët e Kombit"*;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës në Hajvali dhe ndërtimi i trotuareve në rrugën *"Muharrem Fejza"*;
  - ✓ Rikonstruimi i rrugëve *"Garibaldi"* & *"Perandori Justinjan"*;
  - ✓ Ndërtimi i rrugëve në fshatin Prugoc – 15 rrugë;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës te Pallati i Drejtësisë;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës në fshatin Lebanë-Prugoc;
  - ✓ Ndërtimi i rrugëve lokale dhe kanalizimeve fekale në lagjen "Arbëria" – 14 rrugë;
  - ✓ Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në lagjen "Arbëria" – *"Qemal Stafa"* – 21 rrugë;
  - ✓ Ndërtimi i rrugës në Grashticë, lagjja "Cervadik";





- ✓ Ndërtimi i rrugës " Enver Maloku - (faza I);
- ✓ Asfaltimi i rrugës në Hajvali;
- ✓ Ndërtimi i rrugës Besi - Prugoc – Barilevë, e tërë infrastruktura";
- ✓ Ndërtimi i rrugëve lokale në lagjen "Përroi i Njelmët" – 22 rrugë;
- ✓ Ndërtimi i kanalizimeve fekale në lagjen "Prroi i Njelmët" – 4 kanalizime;
- ✓ Ndërtimi i rrugëve me kubëza të betonit në Hajvali – 12 rrugë;
- ✓ Ndërtimi i rrugëve me kubëza të betonit në lagjen e Spitalit – 43 rrugë;
- ✓ Ndërtimi i kanalizimeve në fshatin Vranidoll, Prugoc;
- ✓ Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatrat Llumnicë, Barilevë;
- ✓ Sanimi dhe rikonstruktimi i rrugëve në disa lagje dhe fshatra të Prishtinës (janë rregulluar 14 rrugë dhe 30 kanalizime);

## **Ndërtimi, rregullimi dhe sanimi i kanalizimeve dhe rregullimi i shtratit të lumit:**

- ✓ Rregullimi i shtratit të lumit Prishtina-faza I, segmenti Fusha e Pajtitimit;
- ✓ Rregullimi i përroit dhe kanalizimit fekal nga fshati Shkabaj në drejtim të lagjeve "Arbëria" dhe "Kodra e trimave";
- ✓ Sanimi i kanalizimit fekal te sheshi "Nëna Terezë";
- ✓ Ndërtimi i kanalizimit fekal Bardhosh - Prugoc - Barilevë;
- ✓ Kolektori betonarme për largimin e ujit atmosferik dhe kanalizimit fekal në rrugën Mat dhe në lagjen "Kalabria";

- ✓ Ndërtimi i kanalizimit fekal në Besi - Bardhosh;
- ✓ Ndërtimi i kanalizimit fekal nga fshati Shkabaj në drejtim të lagjes "Arbëria" dhe "Kodra e Trimave";
- ✓ Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen e Xhafollëve të fshatit Barilevë;
- ✓ Ndërtimi i kanalizimit fekal në Mramor - Suteskë dhe vazhdimi i kanalizimit fekal në rrugën "Ibrahim Fehmiu";
- ✓ Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe trotuareve në fshatin Vranidoll;
- ✓ Ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat Sinidoll dhe Bërnice;
- ✓ Rrjeti i ujësjellësit për fshatrat Breznicë – Kozaricë;
- ✓ Ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat Sinidoll dhe Bërnice;
- ✓ Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe trotuareve në fshatrat Serovc dhe Lebanë;
- ✓ Rindërtimi, sanimi i kanalizimeve fekalë parësore dhe dytësore si dhe ndërtimi, sanimi dhe zgjerimi i disa rrugëve sekondare në territorin e komunës së Prishtinës;
- ✓ Ndërtimi i urave në fshatrat e komunës së Prishtinës – 16 ura;







## Rregullimi i hapësirave publike:

- ✓ Rregullimi i parkingut dhe hapësirave të gjelbra në lagjen "Ulpiana";
- ✓ Ndërtimi i dy vendparkingjeve në lagjen "Lakërishtë" prapa bankës "ProCredit";
- ✓ Rregullimi i pllatosë pranë çerdhes së fëmijëve "Lulevera" në lagjen "Dardania";
- ✓ Rregullimi i pllatosë pranë PTK-së në lagjen "Dardania";
- ✓ Rregullimi i parkut në lagjen "Dardania" në Prishtinë;
- ✓ Ndërtimi i Bulevardit mbi Kurriz;
- ✓ Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe terreneve sportive në lagje të ndryshme të qytetit:
  - » Rr. "Afrim Loxha" "**Bregu i Diellit**" (në proces),
  - » Rr. "28 Nëntori" "**Dardani**" (në proces),
  - » Rr. "Shefqet Shkupi" "**Kalabri**" (në proces),
  - » Rr. "Vëllezërit Fazliu" "**Kodra e Trimave**" (në proces);

**Rigjenerimi urban**- Gjatë vitit 2015, ka vazhduar projekti për trajtimin fizik dhe estetik të rrugëve në zonën "Qendër" të kryeqytetit. Është marrë vendimi për uniformimin e të gjitha shkallëve, si dhe rimodelimin e panove-reklamave në ballinat e lokaleve të të gjitha bizneseve që operojnë në rrugët: "*Rexhep Luci*", "*Garibaldi*", "*Perandori Justinian*", "*Luan Haradinaj*" dhe "*Migjeni*". Për rrugët: "*Garibaldi*", "*Perandori Justinian*", "*Luan Haradinaj*", "*Migjeni*" janë në proces të realizimit trotualet për lëvizjen sa më të lehtë të këmbësorëve, shtigjet dhe pllakat taktile për persona me nevoja të veçanta dhe të verbër.



## Transparenca

- ✓ Çdo komunikim në mes të të punësuarve bëhet përmes e-mail adresave zyrtare –para vitit 2014 posta elektronike zyrtare nuk është përdorur nga punonjësit e Komunës dhe shumica e adresave elektronike zyrtare kanë qenë të mbyllura. Me marrjen e detyrës menjëherë kemi bërë hapjen dhe funksionalizimin e sistemit të postës elektronike zyrtare dhe kemi kërkuar nga punonjësit e Komunës që të përdorin vetëm postat elektronike zyrtare dhe jo adresat elektronike private.
- ✓ Plani për Integritet – Komuna e Prishtinës është komuna e parë në Kosovë që ka hartuar dhe zbatuar Planin për Integritet sipas Strategjisë Kundër Korrupsion 2013-2017, të miratuar nga Parlamenti i Kosovës. Plani është udhërrëfyes për institucionin që të parandalojë dhe luftojë korrupsionin.
- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë civile për monitorim të punës së Komunës - Komuna e Prishtinës ka bërë marrëveshje me Lëvizjen "FOL" për monitorimin e prokurimit në çdo fushë.

## Luftë ndaj sjelljeve korruptive

- ✓ Suspendimi i zyrtarëve komunalë të dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare - Komuna e Prishtinës në vitet 2014 - 2015, ka pezulluar 52 zyrtarë komunalë për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Edhe pse ka fakte të mjaftueshme që dëshmojnë për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe korrupsion, Komisioni ka kthyer në punë 21 persona të suspenduar.
- ✓ Gjatë vitve 2014 - 2015, në mbi 90 raste kemi kuptuar se ka pasur keqpërdorim të detyrës zyrtare, mashtrim dhe korrupsion. Të gjitha këto raste janë proceduar në Prokurorinë e Shtetit të cilat ende janë në procedurë gjyqësore.

---

Kemi pezulluar **52 zyrtarë** komunalë për keqpërdorim të detyrës zyrtare

---

Kemi proceduar **mbi 90 raste** në Prokurorinë e Shtetit

# Ndalimi i parregullsive dhe jo konformiteteve

- ✓ Zbatimi i plotë i Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parasë dhe Financimit të Terrorizmit. Ky ligj nuk ishte zbatuar plotësisht deri më 01.04.2014.
- ✓ Shkëputja e kontratës dhe padia ndaj "HIB Petrol"-it. Komuna ka identifikuar se nëpër shkollat e komunës së Prishtinës, nga 42 mostra që janë testuar, është vërtetuar se është përdorur lëndë djegëse e dëmshme. Prokuroria ka vërtetuar se në të gjitha shkollat niveli i sulfurit ka qenë deri në 80 herë më i madh se niveli i lejuar. Për të vërtetuar nivelin e lartë të sulfurit, Komuna ka dërguar mostrat për analiza edhe në një laborator jashtë vendit (në Itali) dhe rezultatet janë të njëjta, niveli i sulfurit ka qenë 800ppm, teksa norma e lejuar është 10ppm.
- ✓ Shkëputja e kontratës me kompaninë "Beni Dona Plast" – Pas disa vërejtjeve ndaj kompanisë për mosrespektimin e plotë të kontratës, dhe duke marrë parasysh dëmet që mund të ishin shkaktuar nga pakujdesia e qëllimshme e kompanisë në shëndetin e fëmijëve, Komuna, në muajin maj të vitit 2015, ka ndërprerë kontratën "Furnizimi me shujta për nxënës të klasëve 1-5" dhe i është ndaluar konkurrimi në tenderët e Komunës së Prishtinës.
- ✓ Shkëputja e kontratës me kompaninë NTP "Douglas" – Pas konstatimit se punimi i dollapëve në shkolla nuk është bërë në përputhje të plotë me kontratën, Komuna e Prishtinës ka marrë vendim për ndërprerjen e kontratës "Furnizimi dhe montimi i dollapëve për ciklet e ulëta të shkollave fillore të komunës së Prishtinës" dhe ka ndaluar këtë kompani të marrë pjesë në tenderët e Komunës së Prishtinës në të ardhmen.
- ✓ Shkëputja e kontratës me kompaninë "Alkoimpex" – Në janar të vitit 2015, Komuna e Prishtinës ka shkëputur kontratën për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, të lidhur në vitin 2013 për shkak të performancës së dobët dhe ankesave të shumta nga qytetarët.
- ✓ Shkëputja e kontratës me kompaninë "Europa Partners" – në janar të vitit 2015, Komuna e Prishtinës ka shkëputur kontratën për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve të lidhur në vitin 2013, për shkak të performancës së dobët dhe ankesave të shumta nga qytetarët.



## Prishtina qendër atraktive për investime dhe krijimi i vendeve të reja të punës

Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit, ka funksionalizuar Qendrën për Këshillim në Karrierë dhe Bussines HUB-in që kanë për synim rritjen e punësimit të të rinjve:

- ✓ **Qendra për Këshillim në Karrierë** ka për qëllim të bëjë ndërlidhjen e shkollave të mesme profesionale me tregun e punës.
  - Komuna e Prishtinës ka **8 shkolla të mesme profesionale**.
  - Në këto shkolla mësimin e vijnë rreth **7100 nxënës**.
  - Në vit diplomojnë rreth **1400 nxënës**.
  - **60%** e tyre vazhdojnë studimet.
  - **40%** tentojnë të punësohen.
- ✓ **Prishtina Bussines HUB (do të mbështes kompanitë të cilat merren me eksportin e shërbimeve jashtë vendit – outsource)**

**Synimi i Komunës së Prishtinës, përmes kësaj qendre, është të punësojë rreth 500-600 të rinjë në vit**

Do të përkrahen bizneset e reja, të cilat merren me eksportin e shërbimeve jashtë vendit). Sot eksportet e shërbimeve paraqesin një trend global dhe kanë një rritje të vazhdueshme. Këto janë kryesisht shërbime në fushën e IT-së. Kosova ka PËRPARËSI KRAHASUESE në këtë drejtim, për shkak se rreth 50% e popullsisë është e moshës së re, nën 25 vjeç.

- ✓ Krijimin e **400 vendeve të punës përmes mbështetjes së investitorëve** në fushën e eksportit të shërbimeve.



# Menaxhimi i pronës komunale

## Evidentimi i pronave komunale - Deri më tani kemi evidentuar pothuajse të gjitha pronat komunale, gjithsej **6183** prona.

- Shfrytëzues për të gjitha zonat kadastrale janë 4,005.
- Shfrytëzimi i pronave komunale për bujqësi janë 300.
- Shfrytëzimi i pronave komunale me objekte janë 2,854.
- ✓ Lirimi i pronës publike – Gjatë viteve **2014-2015**, janë liruar 10 prona komunale.
- ✓ Vlerësimi i pronës komunale - Vlera e tokës komunale 2,207,257,260.90 euro ndërsa vlera e objekteve 148,163,224.50 euro. Vlera totale: 2,355,420,485.40 euro.
- ✓ Ndalimi i shfrytëzimit të hapësirave publike pa leje dhe uzurpimeve – Gjatë këtij viti kemi bërë lirimin e 384 lokacioneve publike nga tavolinat dhe karriget e lokaleve afariste, largimin e 283 shitësve ambulantë, 8 aksione për largim të vazove të betonit etj.
- ✓ **Ndalimi i keqpërdorimeve të ujit të pijes** - Inspektorët kanë bërë 500 kontrollime për keqpërdorim të ujit të pijshëm dhe, në bashkëpunim me KUR "Prishtina", kemi bërë intervenimin për sanimin e gypave të ujit të pijshëm në 25 lokacione, si dhe hapjen e 30 pusetave të kanalizimit në Prishtinë.

**Incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore në qytetin e Prishtinës** - Incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta është realizuar në 145 objekte kolektive të banimit, pra përafërsisht 20% e ndërtesave në Prishtinë, në gjithsej pesë lokacione të ndryshme. Ky incizim ka për qëllim identifikimin, skicimin, matjen e drejtpërdrejtë në terren dhe krijimin e një baze të të dhënave për hapësirat e përbashkëta banesore në komunën e Prishtinës. Projekti është realizuar në 4 zona / lagje, dhe atë në zonën "Qendër" të Prishtinës, konkretisht në pjesët e quajtura:

- Te Qafa, dhe sheshi "Nëna Terezë", janë rilevuar objektet banesore, si dhe janë skicuar, matur hapësirat e përbashkëta banesore dhe punuar rreth 29,70 %;
- Në lagjen "Dardania" - 11,86 %;
- Në lagjen "Ulpiana" - 11,86 %;

## ***Ky projekt do të vazhdojë edhe në vitin 2016.***

- ✓ **Krijimi i kadastrit të përçojave nëntokësore** - Këtë vit Drejtoria e Kadastrit ka shpallur tenderin për kadastrin e përçojave, i cili tender ka të bëjë me evidentimin e përçojave nëntokësore në komunën e Prishtinës. Detyra e projektit për ndërtimin e kadastrit të përçojave dhe objekteve nëntokësore, është rilevimi (kompletimi) i të gjitha përçojave dhe objekteve nëntokësore dhe paraqitja e tyre në pjesën grafike dhe tekstuale. Llojet e përçojave dhe objekteve nëntokësore janë: rrjeti i ujësjellësit, i kanalizimit, i nxehje sjellësit, elektroenergjetike, telekomunikuese, e naftësjellësit, e gazsjellësit, drenazhe, tunelet e përbashkëta, përçoja industriale, objektet nëntokësore (garazhet, rezervarët, kalimet e këmbësoreve, tunelet, strehimoret, bodrumet dhe të tjera të ngjashme. Pra, me këtë projekt ka përfunduar evidentimi i të gjitha përçojave nëntokësore në qytetin e Prishtinës dhe gjatë vitit të ardhshëm do të bëhet evidentimi i këtyre përçojave në data-bazë.
- ✓ **Identifikimi i objekteve komuna të pashfrytëzueshme dhe shndërrimi i tyre në qendra rinore dhe kulturore, të cilat do jenë të hapura për komunitetin:**
- ✓ Objekti "Klubi i Boksit";
- ✓ Kolonia e Artistëve (Bardhosh);
- ✓ Qendra e Mjekësisë Familjare përballë Shkollës "Emin Duraku";
- ✓ Qendra e Mjekësisë Familjare në lagjen "Arbëria";



## Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve mjekësore

- ✓ **Përzgjedhja e shefave dhe personelit të QKMF-ve**, në bazë të kriterëve në formë transparente e në mbikëqyrje edhe të OJQ-ve, sindikatave e komitetit për shëndetësi.
- ✓ **Rishikimi i shpërndarjes adekuate të personelit dhe rishpërndarja e tyre** - bazuar në kriterë transparente dhe sipas nevojës;
- ✓ Ndërtimi i QMF XI në Lagjen e Muhaxhirëve;
- ✓ Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës në këto QMF:
  - Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare - QKMF në qendër;
  - QMF I, në lagjen "Tophane";
  - QMF V, në lagjen "Dardania";
  - QMF VI, në lagjen "Bregu i Diellit";
  - Në proces të renovimit janë:**
  - Dispanseri Anti-tuberkular DAT;
  - Qendra e Mjekësisë Urgjente;
  - QMF–Ish-Gjykata;
  - Ambulanca në fshatin Viti-Marec;
  - Ambulanca në fshatin Slivovë;
- Ambulanca në fshatin Shkllabaj;
- Ambulanca në fshatin Rimanishtë;
- Ambulanca në fshatin Mramor;
- Ambulanca në fshatin Bullaj.
- ✓ **Përpilimi i strategjisë së punës për përmirësimin e shërbimeve mjekësore.**
- ✓ Formimi i Komiteti për Promovim dhe Edukim Shëndetësor. Në kuadër të kësaj u organizuan disa aktivitete nëpër çerdhet dhe shkollat e Prishtinës, me synim të vetëdijesimit dhe edukimit të fëmijëve rreth shëndetit.
- ✓ **Shërbimi Stomatologjik** me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më afër vendbanimeve të qytetarëve, ka bërë që shërbimet stomatologjike nëpër QMF, pikat të cilat kanë punuar vetëm me një ndërresë të punohet tanimë me dy ndërresa. Në QMF IV për shkak të ngarkesës së madhe dhe infrastrukturës së gatshme, kemi funksionalizuar edhe një ordinancë me 2 ekipe dhe tani kemi 4 ekipe në dy ordinanca të Shërbimit stomatologjik në QMF IV.



- ✓ **Organizimi i punës së kujdestarisë 24 orësh të punëtorit social**, ku prezenca e punëtorit social është më se e domosdoshme dhe asnjë intervenim apo intervistë nuk mund të zhvillohet pa prezencën e punëtorit social;
- ✓ Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës në Poliklinikën e Stomatologjisë, Dispanseri-antituberkular;
- ✓ Përmirësimi i dukshëm i kushteve për personelin shëndetësor dhe qytetarët në komunën e Prishtinës;
- ✓ Ngritja e kapaciteteve të resurseve humane dhe teknike për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, si dhe emërimi i koordinatorëve për cilësi dhe promovim të shëndetit;
- ✓ Shërbime të reja, si ultrazëri i kukave tek fëmijët, si dhe identifikimi i problemeve të tjera ostomuskulare dhe shërbime të reja në stomatologji;
- ✓ Pajisja me të gjitha aparataturat e nevojshme dhe më moderne në të gjitha institucionet shëndetësore në komunën e Prishtinës, bazuar në kërkesat e stafit shëndetësor;
- ✓ Standardizimi i procedurave, shpalljeve dhe informatave obligative në të gjitha institucionet shëndetësore;
- ✓ Aktivitete të shumta për parandalim, promovim dhe edukim shëndetësor.

#### **QKMF**

- 01 dhjetor Shënimi i Ditës kundër HIV-AIDS.
- 21-28 janar 2015- Java e Parandalimit të Kancerit të Qafës së Mitrës
- 20 - 21 mars- Shëndeti Oral -Buzëqeshi Jetës
- 24 mars 2015- Dita Botërore e Luftës Kundër TBC.
- Prill 2015 - Java Evropiane e Imunizimit.
- 12 maj - Dita e Infermierisë.
- 17 maj - Dita e Hipertensionit.
- 31 maj - Dita Botërore pa Duhan
- 26 qershor - Dita Ndërkombëtare Kundër Drogës

- 29 Shtator- Dita Ndërkombëtare e Zemrës.
- 30 shtator - Dita e Promovimit të Gjdhënies.
- Tetor - Muaji i Luftës Kundër Kancerit të Gjirit.
- U mundësua mamografia falas për 100 femra të kategorisë së rasteve sociale gjatë tërë muajit tetor.
- 14 nëntor - Dita Botërore Kundër Diabetit.

#### **QMU**

- 07 - 08 janar: Në bashkëpunim me ekspertet e KFOR-it gjerman, në Spitalin Ushtarak -trajnimi për përkrahje bazike për jetë, përkrahja e avancuar për jetë dhe mbështetje paraspitalore për mbijetesë të traumat), Prizren.
- 23 - 30 mars: Me trajnerët nga Suedia është bërë trajnimi për licencimin e 7 dispeçerëve në sistemin e komunikimit „Pratus“.
- 28 maj: -Kursi për defibrilimin e jashtëm, për punëtorët shëndetësorë të QMU-së, Qendrave të Mjekësisë Familjare nga komunat e Kosovës dhe stafi mjekësor i FSK-së.
- 14 - 19 qershor : Ushtrim i organizuar nga Bashkimi Evropian lidhur me menaxhimin e fatkeqësive dhe katastrofave, Maqedoni.
- 21 qershor: Dita e Kujdesit Parësor Shëndetësor, Prishtinë.
- 11 shtator : Dita Botërore e Ndhmës së Parë, Prishtinë.
- Ditën e Menaxhimit të Fatkeqësive.
- 25 -27shtator - Simpozium i përbashkët i punëtorëve shëndetësor nga QMF-të dhe QMU-ja.
- ✓ Faza përfundimtare e publikimit të revistës së parë shëndetësore pas shumë viteve, me qëllim të promovimit, edukimit dhe informimit të qytetarëve, me mbështetje edhe nga OBSH. Emri i revistës " SHËNDETI 038".

# Arsimi

- ✓ Përmirësimi i ushqimit në çerdhe – Nga shkurti i vitit 2015, kemi marrë në menaxhim Kuzhinën Qendrore, e cila gatuan ushqim për 8 çerdhe publike dhe 3 çerdhe me bazë në komunitet. Ushqimi që është gatuar më parë ka qenë ushqim jo kualitativ dhe jo i shëndetshëm. Ndryshimet që kemi bërë kanë përmirësuar shumë ushqimin. Tani fëmijët ushqehen me ushqim të shëndetshëm me vlera ushqyese, yndyrëra, karbohidrate dhe proteina të shëndetshme;
- ✓ Hapja dhe aktivizimi i e-maileve zyrtarë për të gjitha IEAA-të e Prishtinës;
- ✓ Regjistrimi i fëmijëve në çerdhe dhe shkolla në bazë të kriterëve të caktuar;
- ✓ Pajisjet e shkollave me kabinete të shkencave;
- ✓ Furnizimi i sallave të sportit me rekuizita sportive;
- ✓ Funkcionalizimi i qendrave për ngritje profesionale;
- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës në 43 objekte shkollore dhe 6 objekte parashkollore;
- ✓ Drejtorja e Arsimit, gjatë këtij viti ka filluar implementimin e mësimit tërëditor në tri institucione edukativo-arsimore: SHFMU "Faik Konica", SHFMU "Model" dhe SHFMU



"Afrim Gashi";

- ✓ Ka filluar implementimi i digjitalizimit (ditari digjital sokratos dhe përmbajtja mësimore) të disa shkollave;
- ✓ Angazhimi i ekspertëve të jashtëm në raste të përzgjedhjes së stafit edukativo-arsimor;
- ✓ Bashkëpunimi me OJQ të ndryshme dhe ofrimi i mundësisë për zhvillim profesional të mësimeve;
- ✓ Themelimi i zyrës për siguri në shkolla;

- ✓ Organizimi, për herë të parë, i Akademisë së Kosovës për edukim, për qytetari demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut;
- ✓ Organizimi i fushatave vetëdijësuese për të drejtat e fëmijëve, në bashkëpunim me OJQ të ndryshme ( UNICEF, Save the Children, KEC, Syri Vision etj.);
- ✓ Organizimi i fushatës vetëdijësuese kundër ngacmimeve "I'm sorry!"- "Më fall!" në bashkëpunim me OJQ "Drit" në 5 shkolla të komunës

## Eliminimi i dallimeve, privilegjeve dhe largimi i luksit nga qeverisja komunale

---

- ✓ **Ulje në shpenzimet mujore të derivateve për automjetet zyrtare të Komunës** -Organizimi më i mirë dhe shpërndarja e shfrytëzimi më optimal në të gjitha drejtoritë ka rezultuar me zvogëlim të shpenzimeve të derivateve.
- 

- ✓ **Reduktimi i shpenzimeve në dreka dhe darka zyrtare.**
- 

- ✓ **Reduktimi i shpenzimeve në telefona.**
- 

- ✓ **Ndalimi i parkimit për automjete private në parkingun anësor** - Në parkingun kryesor asnjë automjet privat nuk mund të parkohet, përveç automjeteve të personave me nevoja të veçanta, udhëheqësve të grupeve parlamentare dhe ndërrimit të tretë të punëtorëve të sigurimit.
- 

- ✓ **Dorëzimi i të gjitha automjeteve në parkun e automjeteve në fund të orarit të punës.** Asnjë veturë zyrtare nuk mund të qëndrojë jashtë autoparkut pas orarit të punës, përveç automjeteve të cilat përdoren në raste emergjente.



## Qasje të lehtë dhe të barabartë në aktivitetet kulturore publike

- ✓ **Përfshirja e shkollave dhe çerdheve publike në organizimet publike, në koncertet e organizuara nga Komuna-në:** Festën e Pavarësisë, Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, 1 Qershori, "Prishtina Lexon" dhe Festa e Muzikës;
- ✓ **Regjistrimi i artistëve dhe sportistëve në Komunën e Prishtinës;**
- ✓ **Regjistrimi i vullnetarëve të rinj të Prishtinës, këtë vit kemi hartuar planprojektin për vullnetarizmin në Komunën e Prishtinës;**
- ✓ Grumbullimi dhe zgjedhja e repertorit nëpër shkollat fillore për pjesëmarrje në manifestimet dhe organizimet e ndryshme të kulturës;
- ✓ Çmimi "Rexhep Luci" për arkitektët;
- ✓ Kalendar i kulturor – ka përfunduar dizajanimi dhe planifikimi;
- ✓ Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve dhe "Prishtina Lexon" - Kjo kampanjë është mbajtur përgjatë sheshit të kryeqytetit dhe ka zgjatur 3 ditë me radhë. Për këtë organizim DKRS ka bashkëpunuar me afro 50 shkolla fillore dhe çerdhe, me 30 lexues, fytyra publike (aktorë, këngëtarë, politikanë të njohur), rreth 10 organizata joqeveritare dhe dy ambasada të huaja.
- ✓ Dita e Prishtinës;
- ✓ Dite e Muzikës;
- ✓ Festivali Ndërkombëtar i Teatrove të Kukullave;
- ✓ Festivali Ndërkombëtar i Këngës dhe Valleve për Fëmijë "Ylberi i Prishtinës";
- ✓ 28 Nëntori – Dita e Flamurit dhe panairi "Blej Shqip";
- ✓ Shpallja e sportistit të vitit dhe organizimi i turneut memorial të shahut "Hyzri Talla";
- ✓ 11 Qershori – Dita e Çlirimit të Prishtinës - Në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit dhe kabinetin e Kryetarit, është organizuar Akademia Solemne në sheshin "Zahir Pajaziti";
- ✓ Festa e Muzikës – Është performuar muzikë "live" në 9 skena anë e kënd Prishtinës. Festa ka filluar nga ora 14:00 dhe ka zgjatur deri në orën 23:00. Kanë performuar gjithsejt 70 bende dhe solistë. Ky manifestim është bërë në bashkëpunim me Këshillin Britanik, Ambasadën e Francës dhe Aleancën Franceze.





## Mbrojta e punëtorëve

- ✓ Për çdo kontratë të re e kemi vendosur kushtin e pagës minimale ekuivalente me pagën e të punësuarve në Komunë për barazi (momentalisht 240 euro bruto);
- ✓ Sigurimi i kontratave dhe pagesat e pagave në kohë për të gjithë punëtorët që punojnë në kompanitë kontraktuese të Komunës së Prishtinës;
- ✓ Realizimi i plotë i të gjitha kërkesave të Sindikatës së Shëndetësisë Parësor;
- ✓ Realizimi i kërkesave të punëtorëve teknikë në shkolla dhe në ambulanca për barazi në paga, dhe zbatim të Ligjit të punës në kompanitë kontraktuese të Komunës së Prishtinës.
- ✓ Formimi i sindikatës së punëtorëve brenda QPS-së në mënyrë që ajo t'i mbrojë interesat e punëtorëve ashtu siç e parasheh edhe ligji.
- ✓ Qumështi për punëtorët e Administratës së Komunës, zjarrfikësit dhe punëtorët e objekteve kulturore, për herë të parë Komuna ndan qumësht për punëtorët e saj (182 punëtorë) të cilëve u takon sipas rregullores së miratuar në Kuvendin komunal, bazuar në Ligjin mbi sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës (03/L-212).

## Subvencionet

- ✓ Ndryshimi i kriterëve dhe procedurave të ndarjes së subvencioneve - Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Rural, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë përpiluar kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve. Tani, komisioni përbëhet nga pesë anëtarë ,nga të cilët dy janë nga drejtoritë përkatëse dhe tre nga shoqëria civile apo ekspertë të jashtëm.
- ✓ Subvencionet në ndihmë për rastet sociale 350.000 euro – Duke parë nevojën e madhe për ndihmë sociale, në vitin 2014 kemi ndarë 100.000 euro, ndërsa në vitin 2015 e kemi dyfishuar shumën, në vitin 2015 në 250.000 euro. Gjatë vitit 2015 ka pasur rreth 2500 aplikime për subvencione të kategorive sociale dhe trajtimeve mjekësore. Janë ndarë subvencione përrreth 1500 familje nga kategoritë sociale dhe rreth 650 për trajtime mjekësore. Janë ndarë subvencione edhe për 15 familje, pas fatkeqësive natyrore. Nga i gjithë procesi kemi pasur 3 ankesa, me të cilat është duke u marrë komisioni përkatës. Shuma totale e shpërndarë në këto raste është rreth 250.000 Euro. Për herë të parë është duke u digjitalizuar i gjithë procesi dhe me mbarimin e këtij procesi, të gjitha të dhënat do të bëhen publike për qytetarët. Në kuadër të ndihmës për kategori sociale, në këtë vit është organizuar edhe mamografia për 100 gra nga kjo kategori, ku janë ftuar përmes telefonit dhe janë ekzaminuar.



✓ **Subvencionet në zhvillim të kulturës**

- Gjatë vitit 2014-2015, në kaudër të zhvillimit të kulturës janë ndarë subvencione në shumën 528,037.00 euro.

- Financim i institucioneve komunale kulturore ("Dodona", QKF etj);
- Sponsorimi i institucioneve të pavarura kulturore, festivaleve dhe manifestimeve vjetore;
- Botime;
- Arte vizuale, ekspozita;
- Muzikë;
- Manifestime, organizime;
- Film;
- Teatër.



✓ **Subvencionet në zhvillim të sportit** – Gjatë viteve 2014-2015, në kaudër të zhvillimit të sportit janë ndarë subvencione në shumën 405,585.00 euro

- Projektet e sportit,
- Subvencionimi vjetor i klubeve,
- Projektet e rinisë.



✓ **Subvencionet në fushën e arsimit** – Gjatë viteve 2014-2015, në kuadër të zhvillimit të edukimit dhe përkrahjes së projekteve edukative për studentë dhe talentët e veçantë, Drejtoria e Arsimit ka ndarë gjithsejtë **93,803.00 euro**.

Organizimi i garave	<b>17,150.00 euro</b>
Organizimi i garave sportive në nivel komune	<b>79,930.00 euro</b>
Ekskursionet	<b>201,000.00 euro</b>
Shpërblime për mësimdhënësit më të mirë	<b>219,520.95 euro</b>
Mbështetje për botime të librave edukativë	<b>3,756.00 euro</b>
Bursa studentore (127 student x 500 euro)	<b>98,770.00 euro</b>
Mbështetje të projekteve në fushën e edukimit	<b>259,560.00 euro</b>
Mbështetje për talentët e veçantë	<b>40,672.00 euro</b>

## Ngritja e kapaciteteve dhe përkrahja e studentëve

- ✓ **Krijimi i mundësive për studentët e Prishtinës në kryerjen e praktikës profesionale** në institucionet komunale - në drejtoritë komunale, shkolla, QPS etj. Gjatë këtyre dy viteve në Komunën e Prishtinës kanë bërë praktikë 211 studentë. Po ashtu, në bashkëpunim me shkollat e mesme dhe institucionet, 86 nxënës kanë vijuar praktikën 6 mujore dhe 50 nxënës janë duke e vijuar, nxënës të shkollës së mesme *"Hoxhë Kadri Prishtina"* dhe 10 studentë të diplomuar të komunitetit jo shqiptar.
- ✓ **120 bursa për studentët e komunës së Prishtinës** - Këtë vit Komuna ndan 120 bursa për studentët e Prishtinës që studiojnë në universitetet publike të Kosovës për vitin akademik 2014/2015.

## Vendosja e rregullit dhe riorganizimi i qytetit

- ✓ **Rrënim i ndërtimeve ilegale** (objekte pa leje, tejkalime të lejes së ndërtimit, si dhe lloje të tjera të ndërtimeve) - Gjatë vitit 2014, janë rrënuar 53 objekte, prej tyre 6 objekte për banim kolektiv, 9 objekte për banim individual si dhe objektet të tjera, përfshirë anekset, objekte afariste, garazhe, mure rrethuese etj.;
- ✓ **Revokimi i të gjitha lejeve që kanë rezultuar të jenë dhënë në mënyrë të jashtëligjshme.**
- ✓ Largimi i transportuesve të kufomave nga pjesa përballë QKUK-së dhe rigjelbërimi i asaj pjese;
- ✓ Me qëllim të përmirësimit dhe shtimit të sigurisë në transportin urban, sektori i komunikacionit i Drejtorisë së Inspeksionit komunal, ka bërë konfiskimin e rreth 1200 automjeteve - taksi ilegale.
- ✓ **Mbyllja e 23 lokaleve të lojërave të fatit** - Meqë Ligji për Lojërat e Fatit parasheh që këto të jenë të paktën 1.5 km larg institucioneve edukativo-arsimore, dhe të paktën 500m larg njëra tjetrës, Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Doganën dhe Agjencinë Tatimore të Kosovës, ka bërë mbylljen e 23 lokaleve të lojërave të fatit.



# Identifikimi dhe shtimi i hapësirave të gjelbra

- ✓ 30.000m<sup>2</sup> sipërfaqe të gjelbra në lokacione të ndryshme të qytetit. Gjatë dy viteve kemi identifikuar hapësirat e gjelbra të degraduara dhe kemi krijuar hartën me këto hapësira, identifikimin e gjendjes ekzistuese të tyre në terren dhe rregullimin e tyre përmes ndërmarrjes "Hortikultura". Vetëm brenda dy viteve, kemi rregulluar hapësirat ekzistuese dhe kemi shtuar mbi 30.000m<sup>2</sup> sipërfaqe gjelbëruese në lokacione të ndryshme të qytetit.;
- ✓ Është bërë evidentimi, matja, paraqitja grafike etj. e hapësirave të gjelbra të qytetit të Prishtinës. Gjatë kësaj periudhe janë bërë analiza rreth gjendjes ekzistuese, si dhe matja e hapësirave të gjelbra të lagjeve: "Ulpiana", "Dardania", dhe "Bregu i Diellit".



- ✓ Është bërë largimi i rrethojave dhe grilave të hapësirave publike, në mënyrë që këto hapësira të shfrytëzohen si parqe nga qytetarët e Prishtinës;
- ✓ Identifikimi i lokacioneve të mundshme për realizimin e parqeve, të cilat do të jenë në shfrytëzim të qytetarëve. Si

pasojë, janë hartuar projektet për parqe në disa lokacione të Prishtinës, të cilat më tutje janë plotësuar me paramasa dhe parallogaritë, që të jenë të gatshme për tenderim (realizim):

- Parku te Posta Kryesore
- Parkun te 'Rruga B' (përgjatë rr. "Hyzri Talla" dhe rr. "Enver Maloku").
- Parku te Rrethi – rruga "28 Nëntori".
- Parku te BQK-ja.
- Parku te lagjja "Kodra e Trimave". (pranë shkollës 'Zenel Hajdini'),
- Parku te Fusha e Pajtimit.
- Parku te Salla 1 Tetori,
- Parku në lagjen "Kodra e Trimave" (nën varrezat e qytetit).
- Rruga "Ilaz Kodra" (te Termokosi).
- Hapësira në lagjen "Kodra e Diellit".
- Hapësira te rruga B.
- Këndet në rrugën "Xheladin Rekaliu".
- Hapësira në rrugën "Henry Dynant".
- Hapësira te QMF-ja – Emshir.
- Hapësira te QMF në lagjen "Mati 1" (rr. Muharrem Fejza).
- Banesat e Bardha – Hapësira.
- Rregullimi i parkut në lagjen "Dardania", pllatoja te çerdhja "Lulevera" dhe te biblioteka "Hivzi Sylejmani".
- Largimi i 50.000m<sup>3</sup> mbeturina në lagjen "Fusha e Pajtimit" dhe afër Pallatit të Drejtësisë.
- Hartimi i planit lokal të veprimit në mjedis, fushata vetëdijesuese për mbrojtjen e mjedisit në shkollat fillore dhe të mesme, fillimi i projektit shkollat riciklojnë, aktivitetet të ndryshme mjedisore.





## Mirëmbajtja, zgjerimi i gjelbërimit urban dhe mbrojtja e ambientit

- Mbjellja e luleve sezonale 313,699 fidanë në vitin 2014 dhe 288,986 fidanë në vitin 2015.
- Mbjellja e luleve shumëvjeçare 47,770 në vitin 2014 dhe 47,000 në vitin 2015.
- Mbjellja e drurëve dekorativë 1650 fidanë gjatë vitit 2014 dhe 2015 dhe 1850 fidanë të planifikuara për vitin 2016.
- Rikultivimi i sipërfaqeve të gjelbra 17,242 m<sup>2</sup>
- Rrënimi i 119 objekteve, të cilat janë cilësuar si objekte të rrezikshme për qytetarët dhe ambientin.
- Pastrimi i 120 deponive ilegale
- me materiale inerte, amvisërie ose të përziera, të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë për shëndetin e qytetarëve dhe ambientit, si dhe kthimi e këtyre deponive në gjelbërim, në mënyrë që të parandalohet degradimi i ambientit.
- Largimi i kombi-busëve në lagjen "Dardania" (250-300 kombista), të cilët uzurponin një hapësirë të madhe të gjelbërimit dhe hapësirave publike.
- Largimi i veturave të fjetura (rreth 200 automjete), të cilat kanë qenë të vendosura në hapësira të gjelbra.





## Gërmia

- **Funksionalizimi dhe hapja e Qendrës Rekreative** Gërmia për aktivitete të ndryshme në natyrë – Në korrik të vitit 2015, është përkrahur Kampi “Zbulo kopshtin tënd”, organizuar nga OJQ “Toka”, i cili është mbajtur në shtëpizat e Qendrës Rekreative. Mbajtja e këtij kampi ka pasur për qëllim socializmin e të rinjve të lagjeve të ndryshme të kryeqytetit nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme edukative rekreative;
- Hapja e Murit Alpin për alpinistë profesionistë;
- Përfundimi i punimeve dhe hapja e Pishinës së Gërmisë;
- Funksionalizimi i skenës së hapur në Pishinën e Gërmisë për sezonin e verës;
- Zhvillimet në parkun “Gërmia”;
- Procesi i shpalljes së Gërmisë në zonë të mbrojtur dhe zgjerimin e parkut “Gërmia” - Në fillim të vitit 2015, kemi pranuar nga Instituti i Mbrojtjes së Natyrës “Propozimin profesional për shpalljen si zonë e mbrojtur dhe zgjerimin e parkut Gërmia”. Ky propozim është paraqitur në Kuvend, ku edhe është miratuar dhe kanë filluar proceset për debatin publik, i cili ka zgjatuar tre muaj, ku janë dhënë shpjegime në gjitha pyetjet e qytetarëve. Pas proceseve të përfunduara, raporti i përmbledhur i është dërguar Institutit të Mbrojtjes së Natyrës, të cilët e kanë konfirmuar që proceset dhe procedurat janë në rregull dhe Komuna mund të vazhdojë me procesin përfundimtar, shpalljen e parkut Gërmia si zonë e mbrojtur;
- Është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit me WWF-në, organizatën më të madhe në botë për mbrojtjen e natyrës, për një projekt katërvjeçar, në të cilën kjo organizatë do të ndihmojë Komunën në procesin e formimit të strukturës menaxhuese për parkun, në procesin e planifikimit hapësinor, krijimin e planit menaxhues, zhvillimin e programeve edukative, përmirësimin e kushteve përgjatë shtigjeve dhe shënjimin më të mirë të tyre dhe në promovimin e parkut. Të gjitha këto si plotësime të kushteve që parku të certifikohet me certifikatën për turizëm të qëndrueshëm nga Federata Europark;
- Së bashku me klubin alpin “Prishtina”, është bërë identifikimi dhe hartografia e të gjitha shtigjeve të parkut, si fazë e parë për përmirësimin e kushteve nëpër shtigjet e parkut “Gërmia”.



## Dinamikë e re e bashkëpunimit

- ✓ **Vendosja e Prishtinës në hartën e botës** - Komuna e Prishtinës ka filluar të bashkëpunojë ngushtë me qytetet në Evropë dhe botë për zhvillimin e qytetit në të mirë të qytetarëve.
- ✓ **Në mesin e 300 qyteteve në botë, Prishtina** është bërë pjesë e aleancës **"COMPACT OF MAYORS"** në Paris, ku jemi zotuar për ndryshimet e përbashkëta në politika ambientaliste, për t'a bërë jetën e qytetarëve të Prishtinës më cilësore dhe më të shëndetshme. Disa nga projektet e realizuara si kogjenerimi – lidhja e Termokosit me KEK-un, blerja e autobusëve me standardin EURO 6, ndërrimi i ndriçimit publik në led, mbjellja e 2000 drurëve, krijimi i parqeve të reja, izolimi i ndërtesave publike, duke i bërë ato më efeciente ,janë vetëm disa gjëra që po e vendosin Prishtinën në hartën e ndryshimeve për të luftuar ndryshimet klimatike.
- ✓ Në mesin e **35 qyteteve** në botë, Prishtina është bërë pjesë e **Samitit CityLab në Londër 2015**, ku u diskutua rreth ndryshimeve, zgjidhjeve inovative urbane dhe bashkëpunimit mes qyteteve për zgjidhjen e problemeve dhe shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencave.
- ✓ Bashkëpunimi me qytetin e **Zagrebit** është fokusuar në realizimin e projekteve të Komunës në këto çështje:
  - Uji dhe menaxhimi i mbeturinave,
  - Planifikimi urban, Infrastruktura, Zhvillimi i studimeve dhe planeve,
  - Zhvillimi i një modeli të përshtatshëm të transportit urban në Prishtinë,
  - Planifikimi i shëndetit publik'
  - Bashkëpunimi ekonomik midis dy Komunave,
  - Struktura dhe organizimi i Kompanive publike,
  - Bashkëpunimi në fushën e Kulturës,
- ✓ Bashkëpunim i ngushtë me **Tiranën** - në fushën e arsimit, sportit, dhe urbanizmit;
- ✓ Bashkëpunim me qytetin e **Vjenës** në fushën e arsimit, transportit publik dhe menaxhimit të mbeturinave;
- ✓ Bashkëpunim me qytetin e **Gracit** në fushën e arsimit, transportit publik dhe menaxhimit të mbeturinave;
- ✓ Bashkëpunimi me qytetin e **Namurit, Belgjikë** – në fushën e qeverisjes dhe

- reformës së administratës publike, zhvillimit të qëndrueshëm, qytetin inteligjent, trashëgiminë kulturore dhe programet e shkëmbimit midis qytetarëve;
- ✓ Bashkëpunimi me **Taivanin** në fushat: efiçienca e energjisë, sistemet teknologjike në transport publik dhe sisteme të kontrollit të trafikut;
  - ✓ Bashkëpunim me **Bratislavën** në fushën e zhvillimit lokal, mundësitë e ndërlidhjes së sektorit privat, si dhe përparësitë e menaxhimit të shërbimeve komunale efikase;
  - ✓ Bashkëpunim me **Komunën e Biel në Zvicër** në fushën e urbanizimit dhe planifikimit urban;
  - ✓ Bashkëpunim me **Finlandën** në fushën e arsimit;
- ✓ Bashkëpunim të ngushtë me **Universitetin e Prishtinës** në fushat e planifikimit dhe riorganizimit të qytetit, infrastrukturës dhe në fushën e edukimit; **Bashkëpunim me donatorë të ndryshëm, sindikata, organizata jo qeveritare dhe institucione;**
  - ✓ Bashkëpunimi me **Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim** për realizimin e reformës në trafikun urban;
  - ✓ **Bashkëpunim me Bashkimin Evropian** për krijimin e tregut të prodhimeve vendore;
  - ✓ **Marrëveshje Mirëkuptimi me UNDP** -në për të realizuar një hulumtim gjithëpërfshirës (me nxënës, mësime-dhënës e prindër).
  - ✓ **Bashkëpunim të ngushtë me GIZ-in.**
- ✓ Pjesëmarrje në shumë **konferenca botërore**, ku në shumicën prej tyre kryetari ka mbajtur fjalime:
    - **Paris** – Climate Summit 2015,
    - **Vjenë** – District Energy Summit 2015,
    - **Firencë** – Unity in Diversity Conference 2015,
    - **Londër** – CITYLAB Summit 2015,
    - **Tiranë** – Western Balkans OGP Dialogue 2015,
    - **Bruksel** – Exceptional Meeting of Political and Religious Leaders Conference,
    - **Vjenë** – ESMAP Knowledge Exchange Forum: Livable and Energy Efficient Cities 2015.

- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me **Komunën e Obiliqit** për ndërtimin e rrugës në fshatin Bërnice e Ulët, Prishtinë dhe fshatin Mazgit, **Obiliq Bashkëpunim me universitete evropiane dhe vendore:**
- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me **Universitetin Politeknik të Milanos;**
- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me **Universitetin e Antwerp-it në Belgjikë.**





**BEP/USAID, KEC, UNDP, UNICEF, Bit-Media, Save the Children** etj për zhvillimin profesional të mësimeve dhe përmirësimin e cilësisë në shkolla.

- ✓ **Bashkëpunimi me zyrat e BE-së në Kosovë** rreth fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve për punësim për shfrytëzuesit e kategorisë së dytë të skemës së asistencës sociale.
- ✓ **Bashkëpunim i ngushtë me GIZ-in** rreth zhvillimit të strategjisë komunale për shërbimet sociale profesionale, e cila nuk ka ekzistuar asnjëherë më parë dhe për menaxhimin e mbeturinave.
- ✓ **Bashkëpunim me Agjencinë Austriake të Zhvillimit**-me qëllim të realizimit të projektit *"Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në zonat rurale"*.
- ✓ **Bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit** – realizimin e projektit për renovimin e stadiumit të qytetit e cila do të implementohet gjatë viteve 2015-2016.
- ✓ **Bashkëpunim me Postën e Kosovës** – Fillimin e bashkëpunimit dhe asistencë të ndërsjellë për çështjet me interes të përbashkët lidhur me lehtësimin e qasjes në shërbimet postare dhe shërbimet e pagesave, të cilat qytetarët i kryejnë në hapësirat e Komunës.
- ✓ **Bashkëpunimi me EU Beautiful Kosovo Program II (Kosova e Bukur)** - për ndërtimin e çerdhes për fëmijët e lagjes "Arbëria III".
- ✓ Bashkëpunim me OBSH-në për publikimin e revistës "SHËNDETI 038".
- ✓ **Bashkëpunim me organizatë WWF** për mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut "Gërmia" dhe shpalljen e saj zonë të mbrojtur;
- ✓ **Bashkëpunim me Swiss Cooperation Office Kosovo, UNDP, UN-Habitat, USAID, DEMOS** etj në zgjidhjen e problemeve urbane, krijimin dhe rregullimin e hapësirave të gjelbra publike, planifikim hapësiror etj.;



- ✓ Bashkëpunim të ngushtë me Ambasadën Çeke për përmirësimin e kujdesit parësor shëndetësor në identifikimin e problemeve të hershme tek fëmijët e shkollave fillore;
- ✓ Bashkëpunim të ngushtë me Sindikatën e Arsimit SBASHK dhe sindikatën e Punëtorëve Shëndetësor Publik dhe punëtorëve në institucione private;
- ✓ Bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Evropian dhe Bankën Botërore për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore;
- ✓ Bashkëpunim me OJQ-të vendore, si Down Syndrome Kosova, Asociacionin Nacional i Autizmit, Handicap Kosova, Handikos, Shoqata e të Shurdhërve, Komiteti i Grave të Verbër, Shoqata e të Verbërve dhe me të Pamë të Dobësuar, Syri Vision etj.







